



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Drejtoria e Parkut Nacional "Mali Sharr"

Nr. 16 /08
Data: 29.12.2008.
Prizren

PËR: Ismail Rudari, UD Sekretar Permanent në MMPH

NGA: Hazer Dana, Drejtor i Parkut Nacional „Malet e Sharrit”

GJENDJA E RESURSEVE NATYRORE
NË PARKUN NACIONAL PËR VITIN 2008.

DHJETOR 2008.
PRIZREN

Përmbajtja

1. HYRJE
2. EKOSISTEMET PYJORE
 - 2.1. Të dhënat kryesore për ekosistemet pyjore
 - 2.2. Gjendja e ekosistemeve pyjore
 - 2.3. Shfrytëzimi i pyjeve
3. EKOSISTEMET BARISHTORE
 - 3.1. Veçoritë e vegjetacioneve barishtore (kullosave)
 - 3.2. Biodiverziteti i ekosistemeve barishtore
 - 3.3. Gjendja e vegjetacioneve barishtore (kullosave)
 - 3.4. Gjendja e ekosistemeve barishtore dhe resurseve të tjera natyrore në Prevallë
 - 3.4. Shfrytëzimi i sipërfaqeve barishtore
4. GJENDJA E BOTËS BIMORE (FLORËS)
 - 4.1. Gjendja e llojeve endemike drunore
 - 4.2. Gjendja e bimëve endemike barishtore
5. GJENDJA E BOTËS SHTAZORE (FAUNËS)
6. GJENDJA E REZERVATEVE STRIKTE NATYRORE
 - 6.1. Gjendja e rezervateve të pyjeve të rrobullit (Pinetum heldreichii)
 - 6.2. Rezervati natyror Rusenica (vendbanimi i rrëqebullit)
7. GJENDJA E RESURSEVE UJORE
8. SHFRYTËZIMI I RESURSEVE NATYRORE (ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE KOMERCIALE) NË TERRITORIN E PARKUT NACIONAL
9. ZONIMI I PARKUT NACIONAL
10. SFIDAT E PARKUT NACIONAL
 - 10.1. Mungesa e kushteve të mirëfillta për menaxhimin e qëndrueshëm të PN
 - 10.2. Vështirësitë në mbrojtjen e resurseve natyrore
11. REKOMANDIMET PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË PN
 - 1) Masat për krijimin e kushteve për menaxhimin e qëndrueshëm të PN
 - 2) Masat për mbrojtjen e resurseve natyrore në rezervatet strikte natyrore ekzistuese
 - 3) Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve
 - 4) Masat për mbrojtjen e florës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të kullosave
 - 5) Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e faunës
 - 6) Masat për zgjidhjen e çështjes së ndërtimeve dhe menaxhimin e qëndrueshëm të vendeve turistike
 - 7) Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore

1. HYRJJE

Drejtoria e PN „Malet e Sharrit”, për momentin menaxhon me territorin i PN me sipërfaqe prej 22 230 ha që gjendet në komunat e Prizrenit (19 500 ha) dhe Suharekës (2730 ha). Nga kjo sipërfaqe (22 230 ha) pyjeve dhe tokave pyjore i takon 7062.92 ha (32 %), ndërsa vegjetacioneve barishtore dhe sipërfaqeve jopjellore i takon 15 167.08 ha (68 %).

Parku Nacional „Malet e Sharrit” është i pasur me resurse të rralla natyrore të cilat kanë vlera të posaçme shkencore, edukativo-arsimore, rekreative, sportivo-turistike dhe estetike. Në kuadër të vlerave natyrore veçohet shumllojshmëria (biodiverziteti) i florës dhe faunës. Parku nacional posedon:

- afro 2500 lloje të bimëve, në kuadër të cilëve veçohen 323 bimë endemike, ndër të cilët më të rëndësishme janë 20 lloje stenoendemike.
- 112 asociacione bimore,
- 165 lloje të shtazëve të egra,
- mbi 200 lloje të shpendëve,
- 147 lloje të fluturave etj.

Vlerësimi i gjendjes së resurseve natyrore të PN për vitin 2008 është bërë në bazë të aktiviteteve (hulumtimeve, monitorimit dhe kontrollave) të vazhdueshme në terren që janë aplikuar në të gjitha rajonet menaxhuese të Parkut nacional të cilët gjenden në territorët e komunave të Prizrenit dhe Suharekës. Gjatë vlerësimit të gjendjes janë analizuar ndikimet dhe pasojat negative të faktorëve biotik (njeriut, insekteve dhe sëmundjeve bimore) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësit natyrore: era, bora etj.) në florën dhe faunën si dhe ekosistemet pyjore dhe barishtore të PN.

2. EKOSISTEMET PYJORE

Në kuadër të përshkrimit të ekosistemeve pyjore janë paraqitur të dhënat kryesore për ekosistemet pyjore dhe gjendja e pyjeve.

2.1. Të dhënat kryesore për ekosistemet pyjore

Sipërfaqja e pyjeve dhe tokave pyjore

Sipërfaqja e pyjeve dhe tokave pyjore të pjesës së Parkut nacional që gjendet në territoret e KK Prizren dhe KK Suharekë është 7062.92 ha, nga e cila pyjeve i takon sipërfaqja prej 4521.49 ha ose 64 %, ndërsa tokave pyjore 2541.43 ha ose (36 %). Në kuadër të tokave pyjore 2475.86 ose 97 % të sipërfaqës i takon tokave pjellore, ndërkaq sipërfaqja e tokave jopjellore është 65.57 ha ose 3 %.

Struktura e pyjeve sipas formës kultivuese

- Pyjet e larta: 2357.66 ha (52 %)
- Pyjet e ulëta: 1598.95 ha (35 %)
- Kulturat pyjore: 139.27 ha (3 %)
- Shkurret: 425.61 ha (10 %)
- Gjithsej: 4521.49 ha (100 %)

Struktura e pyjeve sipas llojeve drusore

- Pyjet e ahut (*Fagion moesiacaе illyricum*): 3067.09 ha (68 %)
- Pyjet e përziera të ahut dhe rrobullit: 98.80 ha (2.2 %)
- Pyjet e përziera të ahut, bredhit dhe hormoqit: 95.30 ha (2 %)
- Pyjet e rrobullit (*Pinetum heldreichi*): 450.52 ha (10 %)
- Pyjet e bredhit (*Abietum alba*): 30.70 ha (0.7 %)
- Pyjet e hormoqit (*Picetum excelsae*): 5.80 ha (0.1 %)
- Pyjet e përziera të halorëve: rrobulli, bredhi, hormoqi, arneni, hartina: 32.80 ha (0.7 %)
- Kulturat e pishës së zezë dhe të bardhë: 132.62 ha (3 %)
- Kulturat e hormoqit: 6.65 ha (0.1 %)
- Pyjet dhe shkurret e mullezës dhe frashnit të zi (*Orno Ostryetum carpinifoliae*): 499.15 ha (11 %)
- Vegetacioni shkurre i hartines (*Pinetum mughii*): (73.10 ha (1.6 %)
- Shkurret e verrit dhe lajthijes: 28.96 ha (0.6 %)
- Gjithsej: 4521.49 ha (100 %)

Struktura e pyjeve sipas pronësisë

Në territorin e PN-së që shtrihet në komunat e Prizrenit dhe Suharekës, shumica (mbi 90 %) e sipërfaqeve pyjore i takojnë pronës shtetërore.

Analiza e strukturës së pyjeve

Nga analiza e strukturës së pyjeve mund të konstatohet:

- Në territorin e Parkut nacional (KK Prizren dhe KK Suharekë) dominojnë pyjet e ahut (*Fagion moesiacaе illyricum*) me 68 %, gjë që është pasoj e kushteve bioekologjike të rajoneve ku ato gjenden.
- Pyjet më të rëndësishme janë të rrobullit (*Pinetum heldreichii*) për shkak të karakterit endemo-relikt. Këto pyje me sipërfaqe prej 10 % radhiten pas pyjeve të ahut. Pyjet e rrobullit gjenden në malet Oshlak, Koxha Ballkan dhe Pashalare dhe janë mjaftë të dëmtuara si pasoj e zjarreve pyjore në vitet 2000 dhe 2007 si dhe zhvillimit të madh të insekteve dëmtues (nënivorësve të pishës).
- Pjesëmarrja e konsiderueshme (45 %) e pyjeve të degraduara (pyjeve të ulta dhe shkurreve) që është pasoj e shfrytëzimit të pakontrolluar të pyjeve në të kaluarën.
- Sipërfaqja e kulturave pyjore (pyjet artificiale të ngritura me anë të pyllëzimeve) është e ulët (3 %) që nënkupton se në territorin e Parkut nacional (KK Prizren dhe KK Suharekë) dominojnë (97 %) pyjet natyrore e llojeve autoktone. Shumica e kulturave pyjore i takojnë llojeve të pishës së zezë dhe të bardhë të cilët janë mbjellë në fillim të viteve 80-a në pjesën jugore të Oshlakut të rrezikuara nga erozioni.
- Në aspektin e përbërjes së pyjeve dominojnë pyjet e pastra (83.5 %) ndaj pyjeve të përziera (16.5 %)

2.2. Gjendja e ekosistemeve pyjore

Gjendja e pyjeve të Parkut nacional, në veçanti të halorëve, është e vështirë si pasoj e ndikimit negativ të faktorëve biotik (njeriu, insektet dëmtues, sëmundjet) dhe abiotik (zjarret, fatkeqësitë natyrore: era, bora etj.). Këta faktor kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të pyjeve duke shkaktuar dëme të konsiderueshme pyjore. Në disa pyje, në veçanti të rrobullit, ndikimi i faktorëve abiotik dhe biotik rrezikon ekzistencën biologjike të tyre. Në vijim është paraqitur gjendja e pyjeve më të rëndësishme të Parkut nacional:

Gjendja e pyjeve të ahut

Shumica e pyjeve të ahut, të cilët kanë përhapje me të gjerë (68 %) në Parkun nacional është e mirë, ndërkaq një pjesë e këtyre pyjeve kanë pësuar dëme nga prerjet ilegale dhe fatkeqësitë natyrore. Në vijim është paraqitur pasqyra e dëmeve pyjore nga prerjet ilegale gjatë vitit 2008:

Tabela 1. Pasqyra e prerjeve ilegale të pyjeve në vitin 2008.

Njësia menaxhuese	Rajoni menaxhues	Lloji i drunit	Nr. drunjëve të prerë	Vëllimi e dëmit pyjor m ³
Mali Sharr	Guri i Zi	Ahu	19	3.01
Mali Sharr	Manastrec	Ahu	110	40.27
Mali Sharr	Lubinje	Ahu	100	17.57
Mali Sharr/K. Ballkan	Prevallë	Ahu	24	6.95
Koxha Ballkan	Uji i Gropuar	Ahu	6	4.44
K. Ballkan/ Mushtisht	Rusenicë/Kabash	Ahu	478	167.33
Malet e Mushtishtit	Mushtisht	Ahu	112	31.73
Malet e Mushtishtit	Delloc	Ahu	2899	1336.74
Gjithsej				1608.04

Dëmi i përgjithshëm pyjor në vitin 2008 nga prerjet ilegale në PN ka qenë 1608.04 m³. Dëmet më të theksuara në vlerë prej 1336.74 m³ ose 83 % nga dëmi i përgjithshëm kanë ndodhur në rajonin e Dellocit (KK i Suharekës), ndërsa në 7 rajonet e tjera menxhuese të PN ka pasur dëme pyjore në vlerë prej 271.3 m³ ose 17 % nga dëmi i përgjithshëm. Në paraqitjen e prerjeve masive (katastrofike) ilegale në rajonin e Dellocit kanë ndikuar shumë faktor, mirëpo faktori kryesor paraqet mos angazhimi, neglizhenca dhe mungesa e përgjegjësisë së kujdestarit të këtij rajoni ndaj detyrave të punës dhe pasurisë shtetërore të PN. Ky kujdestar edhe për kundër dëmit jashtëzakonisht të madh pyjor nga prerjet ilegale në vlerë prej 1336.74 m³, nuk e ka paraqitur asnjë raport në DPN dhe asnjë fletëparaqitje për vjedhje pylli në gjykatë.

Këto prerje masive të pyjeve i kanë verifikuar dhe kanë shrehur vërejtje ndaj kësaj gjendje katastrofike edhe Inspekcioni komunal i Suharekës, Inspekcioni i pyjeve i MPZHR, APK Zyra në Prizren, Policia e nënstacionit Mushtisht dhe Njësia për Krime Ekonomike-Regjioni Prizren.

Si pasoj e prerjeve masive të pyjeve në këtë rajon, PN dhe Republikës së Kosovës janë shkaktuar dëme të konsiderueshme ekologjike, sociale dhe ekonomike (financiare) në vlerë prej 412 356.00 €, nga shuma e përgjithshme e dëmit pyjor prej 498 247.00 €.

Duhet theksuar se kujdestari i rajonit të Dellocit është i suspenduar prej muajit tetor pasi që është arrestuar (paraburgosur) nga Njësi i Krimeve Ekonomike-Regjioni i Prizrenit dhe është nën hetime për dyshim të bashkëpunimit me vjedhësit të pyjeve

Në rajonin e Mushtishtit prerjet më të theksuara janë paraqitur në vendet „Laz” dhe „Guri i Gjatë” të cilët kanë qenë pasoj e mungesës së kujdestarit gjatë periudhës qershor-gusht. Në rajonin e Rusenicës si pasoj e shfrytëzimit të gurit nga firma „Vëllazërit e Bashkuar” nga Mushtishti, tërësisht janë dëmtuar pyjet e ulëta në sipërfaqe prej afro 1 ha.

Prerjet ilegale në territorin e KK të Prizrenit në krahasim më atë të KK të Suharekës, janë dukshëm më të vogla dhe kryesisht shfaqen në rajonet e Manastrecit, Ljubinjës dhe Prevallës.

Ndikimi i faktorëve të tjerë biotik dhe abiotik në pyjet e ahut është i kufizuar pasi që nuk kanë përhapje të gjërë. Në rajonet e ndryshme të pyjeve të ahut vërehet prania sporadike e faktorëve fitopatologjik (sëmundjeve bimore), në kuadër të cilëve veçohen tumori i lëvorës (*Nectria ditissima*) dhe kërpurdha e kalbjes (*Fomes fomentarius*) të cilët paraqiten kryesisht në drunjët e ahut me imunitet të dobësuar si pasoj e vjetërsisë dhe dëmtimeve të ndryshme të shkatuara nga faktorët e tjerë biotik dhe abiotik.

Dëmtime sporadike në pyjet e ahut gjatë vitit 2008 janë verifikuar edhe nga fatkeqësia natyrore (era dhe bora), mirëpo intenziteti i tyre nuk ka ndikim të posaçëm negativ në zhvillimin e pyjeve. Dëme më të theksuara nga fatkeqësia natyrore kanë ndodhur në vitet 2004 dhe 2007 në rajonet e Lubinjës, Manastrecit dhe Gornjasellës, me çrast janë dëmtuar disa dhjetra hektar të pyjeve të ahut.

Ripërtëritja natyrore e pyjeve të ahut është e pamjaftueshme si pasoj e dëndësisë së pyjeve dhe shtresës së trash të legushës (stelës) pyjore në sipërfaqen e tokës. Ripërtëritja më e theksuar natyrore është e pranishme në rajonet e Prevalës (KK Prizren) dhe Uji të Verdhë (KK Suharekë) si pasoj e rralimit të pyjeve nga prerjet e rregullta që janë bërë para dhe pas vitit 1999. Në pyjet e ahut, në vendin Uji i Verdhë, vërehet ripërtëritja e madhe e bredhit i cili në disa pjesë të pyjeve ka filluar të dominoj ahun.

Gjendja e pyjeve të rrobullit

Gjendja shëndetësore e pyjeve të rrobullit (*Pinetum heldreichii*) është e keqe si pasoj e zjarreve pyjore që kanë ndodhur në vitet 2000 dhe 2007 si dhe zhvillimit të madh të insekteve dëmtues (nënivorësve të pishës *Blastophagus* sp.) që janë shfaqur në mënyrë masive pas zjarreve si rezultat i dobësimit të imunitetit të drunjëve të dëmtuara. Nga këta faktor (zjarri dhe insektet) tërësisht dhe pjesërisht janë dëmtuar mbi 100 ha të pyjeve të rrobullit në Oshlak dhe Koxha Ballkan. Duhet theksuar së në kuadër të pyjeve të dëmtuara gjenden edhe rezervatet strikte natyrore të rrobullit: Maja e Arnenit (30 ha), Oshlak (25 ha) dhe Pisha e Madhe (35 ha) të cilët, gjithashtu, kanë pësuar dëme të konsiderueshme pyjore. Pyjet rrobullit, për shkak të karakterit endemorelikt, paraqesin pyjet më të rëndësishme të Parkut nacional, mirëpo, pikërisht këto pyje janë edhe më të dëmtuara. Pasi që shumica e drunjëve të rrobullit janë të prekur nga zjarri pyjor dhe nënlivorsit e pishës, ekziston mundësia e zgjerimit të tharjes së pyjeve të rrobullit duke rrezikuar ekzistencën biologjike të këtyre pyjeve, në veçanti në rajonet e Pishës së Madhe dhe Prevallës. Drunjët e thara janë të nënshtruara proceseve të kalbjes dhe thyerjeve që shkaktohen nga erërat e forta malore.

Ripërtëritja natyrore e pyjeve të rrobullit është duke munguar, si pasojë e dëmtimeve të konsiderueshme të pyjeve, dobësimit të vitalitetit të drunjëve si dhe pranisë së dendur të llojeve barishtore. Në pjesët më të dëmtuara të këtyre pyjeve, në veçanti në Prevallë, ka filluar, në mënyrë intenzive, zhvillimi i filizave të shëlgut të egër (*Salix caprea*) i cili zakonisht paraqitet pas zjarreve pyjore. Ky lloj drunor nuk ka vlerë ekonomike dhe shkencore. Gjithashtu vërehet zhvillimi i madh i bimeve barishtore, në veçanti të epilobit gjethengushtë (*Epilobium angustifolium*), i cili e pengon ripërtëritjen natyrore të rrobullit. Gjendja e pyjeve të rrobullit, duke marrë parasysh intenzitetin e madh të tharjes së tyre, mund të vlerësohet si katastrof natyrore.

Duhet theksuar së Drejtoria e PN-ja për sanimin e gjendjes pyjeve të rrobullit i ka paraqitur masat higjieniko-sanitare në Planet vjetore menaxhuese dhe Projektet për mbrojtjen e pyjeve gjatë periudhës 2002-2008, mirëpo deri më tani asgjë nuk është ndërmarr për evitimin e dëmeve në pyjet e rrobullit.

Për përcaktimin e masave adekuate në sanimin e pyjeve të rrobullit propozohet formimi i një komisioni profesional i përbër nga ekspertet e institucioneve vendore (DPN, IKMN, APK, FSHMN) dhe ndërkombëtare që kanë përvojë për rastet e ngjajshme në parqet nacionale europiane apo botërore. Duke marrë parasysh faktin së kemi të bëjmë me pyjet endemorelikte të rrobullit ku masat sanitare në disa zona janë të vonuara, ndërsa ndërmarrja e masave sanitare kërkon ndërhyrje të intenzitetit të lartë me çka do të ndryshohet tërësisht autoktoniteti i ekosistemeve pyjore të Parkut nacional, duhet shikuar mundësinë që proceset biologjike të lihen natyrës, ndërsa nga masat sanitare të aplikohet vetëm vendosja e feromoneve (kurtheve biologjike) për asgjësimin e nënlivorësve.

Gjendja e kulturave pyjore

Gjendja e kulturave të pishës së zezë dhe të bardhë është relativisht e mirë. Dëmtime të konsiderueshme kanë pësuar kulturat e pishës në malin Oshlak mbi fshatin Streckë nga zjarri pyjor në gusht të vitit 2006, me çrast janë djegur tërësisht afro 25 ha të këtyre kulturave të mbjellura në fillim të viteve 80-a. Duhet theksuar se zjarret pyjore paraqesin rrezikun permanent për pyjet e halorëve, në veçanti për kulturat e pishës dhe pyjet e rrobullit. Shkaktari kryesor i zjarreve në territorin e Parkut nacional është faktori antropogjen (njerëzit e pandërgjegjshëm dhe pakujdesëshëm).

Dëme të theksuara në formë të thyerjes së majeve të trungjeve dhe degëve kanë pësuar edhe kulturat e pishës në parcelat pyjore 51 dhe 52, në afërsi të „Kthesës së Gajshtë” në Oshlak nga fatkeqësia natyrore (bora dhe era) që kanë ndodhur në nëntor të vitit 2007.

Nga faktorët biotik që janë paraqitur në kulturat e pishës në rajonin e gjërë të Prevallës (parcela pyjore 52) veçohen nënlivorësit e pishës. Dëmet pyjore të shkaktuara nga këta dëmtues, për momentin, janë të vogla, mirëpo në të ardhmen pritet përkeqësimi i gjendjes në qoftë se nënlivorësit zhvillohen me intenzitet të lartë.

Në territorin e Parkut nacional, përveç kulturave të pishës, gjenden edhe kulturat pyjore të hormoqit, të cilët janë mbjellur në rajonin e Prevallës, vendi „Fierishte”, në fillim të viteve 80-a, me qëllim të zhvillimit të pyjeve të halorëve në vendbanimet e ahut. Sipërfaqja e këtyre kulturave pyjore është e vogël (6.65 ha), ndërsa gjendja e tyre është e vështirë si pasojë e dëmtimit nga bagëtia dhe insekti dëmtues i quajtur hermesi. Këta faktor e kanë penguar zhvillimin normal të kulturave të hormoqit të cilët karakterizohen me rritje të ngadalshme dhe kulitet të dobët. Në kuadër të kulturave vërehen filizat e reja të hormoqit si dhe prania e shumtë e filizave të ahut në disa pjesë të kulturave të cilët rrethohen me pyjet e ahut.

Në kulturat e pishave dhe të hormoqit, në të kaluarën, nuk janë ndërmarr masat mbrojtëse dhe silvikulturore (pastrimet, rrallimet etj.) me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe strukturës së tyre. Kjo ka ndikuar në dendësinë e madhe të këtyre kulturave, rritjen e ngadalshme dhe kualitetin e dobët të trungjeve.

Gjendja e pyjeve të përziara të ahut dhe halorëve

Ahu, përveç pyjeve të pastërta, formon edhe bashkësitë pyjore të përziara me halorët: bredhin, hormoqin dhe rrobullin në Njësitë menaxhuese „Koxha Ballkan” dhe „Malet e Mushtishtit”. Gjendja e këtyre pyjeve paraqitet e qëndrueshme për shkak të rezistencës më të madhe ndaj faktorëve biotik dhe abiotik. Pyjet e përziara të ahut me halorët, pasi që gjenden në vendet e larta malore, larg vendbanimeve (fshatrave), nuk dëmtohen nga prerjet ilegale. Kjo ka ndikuar në mbrojtjen më të mirë të tyre, mirëpo, për shkak të kushteve të vështira natyrore dhe shfrytëzimit të tyre nga pylltaria në të kaluarën kualiteti i pyjeve të përziara (gjethor dhe halor) është i dobët.

Ripërtëritja e pyjeve të përziara është relativisht e mirë, ndërsa nga llojet që kanë ripërtëritje më të theksuar dallohet bredhi dhe atë në Njesinë menaxhuese „Malet e Mushtishtit”.

Gjendja e vegetacionit shkurror të dredhikut (Pinetum mughi)

Vegjetacioni shkurror i dredhikut gjendet mbi vegetacionin pyjor në malet Pashallare, Koxha Ballkan dhe Oshlak, ndërsa një sipërfaqe e vogël e këtij lloji gjendet edhe në malin Sharr, mbi zonën e Ujrave të Humbur (Gine vode). Gjendja e vegetacioneve të dredhikut është e mirë. Në të kaluarën, në mesë të viteve e 80-ta, në rajonin e Pashallarës si pasojë zjarrit është dëmtuar një pjesë të madhe të vegetacionit të dredhikut, mirëpo tani vërehet stabilizimi i gjendjes dhe kthimi i ngadalshëm në sipërfaqet e djegura. Vegjetacioni i dredhikut, përveç vlerave shkencore, ka rëndësi të veçantë ekologjik për shkak të mbrojtjes së tokës nga erozioni.

Ripërtëritja natyrore e dredhikut është e kufizuar si pasojë e dendësisë së madhe të vegetacioneve të tyre dhe kushteve të vështira klimatike. Në ekspozicionin verior të Oshlakut në vegetacionet e dredhikut është verifikuar zhvillimi i mushteknës (Betulla pendulla) duke krijuar kështu bashkësinë e re të këtyre dy llojeve drunore. Duhet theksuar se me zhvillimin intenziv të mushteknës dukshëm është kufizuar hapësira për zhvillimin e dredhikut.

Gjendja e pyjeve të ulëta dhe shkurrave të mullezës dhe frashnit të zi

Vegjetacionet pyjore dhe shkurre të mullezës dhe frashnit të zi gjenden në pjesët më të ulëta të Parkut nacional në Oshlak dhe Rusenicë dhe paraqesin brezin e parë pyjor në aspektin vertikal. Gjendja e tyre është e vështirë si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar në të kaluarën nga banorët lokal. Roli kryesor i bashkësive të mullezës dhe frashnit të zi është mbrojtja e tokës nga erozioni pasi që gjenden në pjesët e pjerrta jugore ku mbizotrojnë kushtet e vështira klimatike dhe hidrologjike.

Këto vegetacione kanë përdarje vegetative ashtu që ripërtëritja e tyre natyrore me anë të farave plotësisht mungon.

2.3. Shfrytëzimi i pyjeve

Shfrytëzimi i pyjeve në PN nuk aplikohet, ndërsa shfrytëzohet vetëm masa drunore e trungjeve të dëmtuara nga faktorët biotik dhe abiotik (zjarret, era dhe bora) që krijohet në kuadër të ndërhyrjeve sanitare (rrallimeve dhe pastrimeve) në pyjet që i takojnë zonës së dytë të mbrojtjes ku lejohet aplikimi i masave sanitare me qëllim të përmirësimit të gjendjes së pyjeve dhe sigurimit të zhvillimit të qëndrueshëm të tyre. Në këtë vit janë ndërmarr masa tejet të kufizuara sanitare (pastrime) në pyjet e ahut në rajonet e Lubinjës dhe Manastrecit, ndërsa masa e dëmtuar drunore e krijuar nga këto ndërhyrje sanitare është shitur banorëve lokal si dru djegëse për të mbuluar nevojat (kërkesat) e tyre për ngrohje në sezonën dimërore.

3. EKOSISTEMET BARISHTORE

3.1. Veçoritë e vegjetacioneve barishtore (kullosave)

Vegjetacionet barishtore e mbulojnë 68 % të territorit të Parkut nacional (komunat e Prizrenit dhe Suharekës), të cilët, në aspektin e destinimit, kryesisht shfrytëzohen si kullosa.

Kullosat e PN nga aspekti i përrardhjes diferencohen në primare dhe sekondare.

Kullosat primare (kullosat e maleve të larta) janë pasoj e ndikimit të faktorëve klimatik gjatë historisë së zhvillimit të vegjetacioneve në periudhat e ndryshme gjeologjike. Këto kullosa shtrihen mbi vegjetacionin pyjor deri të majet më të larta (prej 1600 m deri mbi 2300 m), ku gjendet mbulesa barishtore. Këto kullosa përbëhen nga bimët barishtore në kuadër të cilëve dominojnë bashkësitë e barit (graminae). Për shkak të lartësisë së madhe mbidetare dhe kushteve të ashpra klimatike ato shfrytëzohen vetëm gjatë sezonës verore, kryesisht gjatë periudhës maj-shtator.

Kullosat sekondare janë kryesisht kullosat që njëri i ka krijuar në tokat pyjore duke shkatërruar pyjet në favor të krijimit të tokave bujqësore (kullosave). Kullosat sekondare shtrihen nën 2000 m dhe kryesisht shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive të banorëve lokal.

Dallimi midis kullosave primare dhe sekondare qëndron në faktin se kullosat sekondare kanë destinim të përkohshëm sepse sipas nevojave shoqërore mund të transformohen në pyje apo sipërfaqe të urbanizuara dhe turistike. Kullosat sekondare (kullosat pyjore) janë më sipërfaqe më të vogël dhe me kualitet më të dobët të mbulesës barishtore në krahasim me kullosat primare (kullosat e maleve të larta) si pasoj e shfrytëzimit intenziv nga bagëtit e banorëve lokal. Kapaciteti i kullosave të maleve të larta është 3 bagëti në 1 ha, ndërkaq 2.5 për kullosat pyjore.

3.2. Biodiverziteti i ekosistemeve barishtore

Ekosistemet barishtore të maleve të larta të Parkut nacional kanë biodiversitet të pasur floristik, në kuadër të cilëve veçohen llojet e shumta endemike. Bimët barishtore që gjinden në pjesët e poshtme të këtyre kullosave i takojnë familjeve: Veratrum, Senecio, Aquilegia, Trollius, etj., ndërsa në pjesët më të larta në zonën e livadheve alpike gjenden llojet e

familjeve Ranunculus, Primula, Androsace, Saxifraga, Silene, Gentiana etj. Llojet më të rëndësishme shkurre në kullosat e Parkut nacional janë boronica (Vaccinium myrtillus), dëllinja e rëndomtë (Juniperus communis) dhe dëllinja e maleve të larta (Juniperus nana). Biodiverziteti i pasur me llojet e shumta endemike është tregues për vlerat e jashtëzakonshme natyrore të Parkut Nacional „Malet e Sharrit” që këtë Park e bënë të veçantë jo vetëm në Ballkan por edhe në Europë.

3.3. Gjendja e vegjetacioneve barishtore (kullosave)

Gjendja e kullosave të maleve të larta është e mirë, pasi që shfrytëzimi i tyre dukshëm është zvogëluar pas luftës së 1999 si pasojë e zvogëlimit drastik të numrit të bagëtive në fshatrat përreth territorit të PN dhe në regjionin e Prizrenit në përgjithësi. Kullosat e melave të larta, siç është cekur më lartë, karakterizohen me biodiversitet të pasur floristik, në kuadër të cilit rëndësi të veçantë kanë llojet endemike barishtore. Gjendja e bimëve endemike paraqitet e mirë, mirëpo, rigjenerimi i tyre është mjaftë i kufizuar si pasojë e kushteve të vështira klimatike, numrit të vogël të tyre dhe domonimit të llojeve të tjera barishtore.

Gjendja e kullosave pyjore është kryesisht e mirë, ndërsa dëmtimet e theksuara janë paraqitur në Prevallë (KK Prizren) dhe Gradanc (KK Suharekë) si pasojë e ndërtimit të objekteve ndërtimore. Në përkeqësimin e gjendjes së vegjetacioneve barishtore në Prevallë kanë ndikuar edhe parkimi i automjeteve dhe hudhja e mbeturinave nga vizitorët e shumtë që e vizitojnë këtë vend. Gjatë dy viteve të fundit janë rrezikuar nga degradimi edhe vegjetacionet barishtore në rajonin e Gurit të Zi si pasojë e shtimit të numrit të vizitorëve gjatë verës, në veçanti ditëve të uikendit. Në rritjen e numrit të vizitorëve në këtë rajon ka ndikuar hapja e rrugës prej fshatit Zapluzhe deri të territori i PN në vitin 2006.

Në vendin Gradanc pas vitit 2005 ka filluar ndërtimi, më intenzitet të shtuar, të objekteve ilegale nga druri. Pronarët e këtyre objekteve edhe përkundër vërejtjeve i kanë vazhduar punimet dhe nuk janë paraqitur në Zyrët e Drejtorisë së PN. Problemin më të madh paraqesin vizitorët e shumtë që deportojnë në brendësi të PN (Gradanc, Uji i Verdhë dhe Kroni i Mbretit) në veçanti gjatë ditëve të uikendit të cilit vështirë mund të kontrollohen. Duhet theksuar se vizitorët janë duke e mbajtur pastër mjedisin natyror në Gradanc dhe janë të gatshëm të paguajnë taksat për qëndrimin e tyre në territorin e PN. Problemin permanent në këtë zonë paraqesin zjarret e hapura që i ndezin vizitorët në afërsi të pyjeve duke rrezikuar shfaqjen e zjarreve pyjore.

3.4. Gjendja e ekosistemeve barishtore dhe resurseve të tjera natyrore në Prevallë

Në Prevallë janë duke u zbatuar dy plane kontestuese (kundërligjore): ndërtimi i fshatit turistik dhe kampingu veror, të cilit kanë pasojat shkatërruese për natyrën dhe peisazhin e mbrojtur të PN të cilët janë përshkruar në vijim.

Ndikimet negative të PRRU „Prevalla” në mjedisin natyror të Parkut nacional

Ndërtimi i dendur dhe masiv i mbi 360 objekteve ndërtimore (ashtuquajturit „fshatit turistik”) me një sipërfaqe të madhe të natyrës prej 17 ha (24 fusha të futbollit) në Prevallë ndikon në shkatërrimin e përmasave katastrofike të natyrës dhe çrregullimet drastike ekologjike në mjedisin natyror, ku veçohen:

•Shkatërimi i tërësishëm i sipërfaqeve të konsiderueshme (17 ha) të natyrës

Ndërtimet masive të objekteve në sipërfaqen prej 17 ha do të shkatërrojnë tërësisht të gjitha elementet e natyrës: florën dhe faunën, biodiversitetin, ekosistemet barishtore, shkurre dhe pyje. Në veçanti do të pësojnë pyjet e përziera të llojit të rrallë endemo-relikt të rrobullit me llojet e tjera drunore (arnenin, ahun, mushteknën, panjën, pishën, plepin, shelgun, frashnin, verrin, dëllinjën, etj.), pasi që ku Plan parasheh ndërtimin e objekteve private në tokën shtetërore të Parkut nacional dhe shkatërrimin, ndër të tjerash, edhe afro 4 ha të këtyre pyjeve shtetërore, gjë që paraqet një veprim katastrofik të papar deri më tani në Kosovë. Duhet theksuar se, deri sa nga Buxheti i Kosovës investohen me miliona euro në pyllëzime (ngritjen e pyjeve të reja) dhe sanimin e pyjeve të dëgruara, në zonën e mbrojtur me Ligj të Parkut nacional shkatërrohen pyjet endemike për t'u ndërtuar objektet private. Në zonat ku shkatërrohet flora (bimet) zhduket edhe fauna (kafshët e egra - llojet e gjitarëve, shpendëve etj.). Me ndërtimin e vendbanimit njerëzor (fshatit me mbi 360 objekte) dhe rritjen drastike të pranisë së njerëzve në natyrën e ruajtur të Prevallës, në veçanti do të rrezikohen llojet e rralla të bimëve dhe kafshëve që janë në zhdukje e sipër, të cilët janë të regjistruara në Librin e Kuq European dhe Botëror dhe të mbrojtura me Ligjet vendore (LMN 12, 13, 15, 16) dhe ndërkombëtare (Konventat e KB dhe Direktivat e BE-së). Bimët më të rrezikuara janë: rrobulli (*Pinus heldreichii*), *Verbascum scardicum* (lloji stenoendemik), *Lilium albanicum*, *Arabis bryoides*, *Laserpitium siler* dhe mbi 100 lloje të tjera endemike (të rralla), ndërsa nga kafshët e shumta, që Prevallën e kanë pasur vendbanim mijavjeqar, të rrezikuara janë: rreqebulli (*Lynx lynx*), pulegra e madhe (*Tetrao urogallus*), shqiponja e përhimtë (*Aquila crusaetos*), shqiponja kryqëzore (*Aquila heliaca*), etj. Prevala paraqet rezervatin e ornitofaunës (shpendëve) që është unikat në Europë i cili, me ndërtimin e ashtuquajturit „fshatit turistik” do të zhduket.

•Shkatërimi i rezervatit strikt natyror të pyjeve të rrobullit „Maja e Arnenit”

Pyjet e rrobullit në Prevallë në sipërfaqe prej 30 ha, për shkak të vlerave të jashtëzakonshme natyrore dhe shkencore janë shpallur në vitin 1960. si rezervat strikt natyror. Ky rezervat i takon kategorisë së I (parë) të mbrojtjes, sipas Unionit Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës (IUCN) dhe gëzon mbrojtje të veçantë Ligjore (LMN nenet 21, 22). Ashtuquajturi „fshati turistik” planifikohet të ndërtohet në afërsi të këtij rezervati natyror, gjë që paraqet një veprim që është në kundërshtim me Ligjet vendore dhe konventat ndërkombëtare për zonat e mbrojtura. Ndërtimet masive të objekteve do të ndikojnë në ndryshimin drastik të kushteve të vendbanimit të rrobullit me çka do të rrezikohet seriozisht mbijetesa biologjike e këtij lloji endemo-relikt drunor i cili është në gjendje të vështirë shëndetësore si pasojë e zjarreve dhe zhvillimit të insekteve dëmtes.

•Ndryshimi i mikroklimes se rajonit të Prevallës

Objektet e dendura ndërtimore në një sipërfaqe të madhe natyrore (17 ha) ndikojnë në:

- apsorbin dhe reflektimin e rrezeve (nxehësisë) të diellit,
- ndryshimin e përbërjes (rritja drastike e pranisë së pluhurit, CO₂, tymit etj.) dhe dendësisë së ajrit,
- ndryshimin e regjimit të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore etj.

Këto ndikime negative në mjedisin natyror do të shkaktojnë ndryshime drastike klimatike që do të shprehet (karakterizohet) me rritjen e temperaturës mesatare vjetore dhe zvoglimin e lagështisë së tokës dhe ajrit. Ndryshimet klimatike do të ndikojnë drejtpërdrejt në ndryshimin e kushteve natyrore të vendbanimeve të florës, faunës dhe bashkësive të tyre. Në veçanti do të rrezikohet mbijetesa e mbi 100 llojeve të bimeve dhe kafshëve të rralla endemike të cilët kanë ndikuar që rajoni i Prevallës të veçohet me vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe të shpallet si Park nacional me rëndësi të veçantë për Kosovën, Ballkanin dhe Europen.

•Ndryshimi dhe shkatërrimi total i vlerave burimore natyrore dhe peisazhore të Prevallës

Prevalla karakterizohet me vlera burimore natyrore dhe pejsazhe të bukura të paprekura nga dora e njeriut. Pikrisht ky origjinalitet i pandryshuar natyror ka ndikuar që ky rajon të vihet nën mbrojtje Ligjore dhe të shpallet si Park nacional, ndërsa me këtë ashtuquajturin Plan rregullativ tentohet që këto vlera të jashtëzakonshme natyrore të ruajtura me shekuj të shkatërrohen për një moment të shkurtër. Paramendoni se çka do të thotë ndërtimi i 360 objekteve me një qytet, me siguri së pamja e qytetit dukshëm do të ndryshonte, ndërsa mendoni mirë se çfarë shkatërrimi dhe ndryshimi drastik do të bëhet në natyrën e mbrojtur të Parkut nacional, në qoftë se ndërtohen mbi 360 objekte. Me ndërtimin kaq masiv të objekteve do të shkatërrohen tërësisht vlerat natyrore të PN, gjë që është në kundërshtim me Ligjet e Kosovës, Konvetnat ndërkombëtare dhe logjikën njerëzore.

•Humbja e vlarave hidrologjike të Prevallës

Prevalla posedon vlera të veçanta hidrologjike që karakterizohen me burime të shumta ujore, prrocka dhe lumej që i takojnë ujërrjedhjeve të dy lumejve: Lumbardhit dhe Lepencit. Për furnizimin e një fshati të madh me mbi 360 objekte nevojitet infrastruktura voluminoze e ujësjellësit dhe kanalizimit që ndikon në ndryshimin drastik të regjimit të ujrave në rajonin e Prevallës që nënkupton:

- ndryshimin e autoktonitetit (orgjinalitetit natyror) të burimeve ujore,
- zvoglimin e sasisë së ujit të prrockave dhe lumejve, në veçanti të Lumbardhit,
- ndotjen e ujit nga ujrat e zeza të mbi 360 objekteve,
- krijimin e ujrave sipërfaqësore që ndikojnë në proceset e erozionit,
- zvoglimin e ujrave nëntokësore etj.

•Humbja e vlerave estetike (bukurisë) dhe turistiko-rekreative të natyrës

Prevalla karakterizohet me ambientin e paprekur natyror që ndikon në bukurinë e veçantë të këtij rajoni. Bukuritë natyrore (ambientet e ruajtura dhe ajri i pastër) paraqesin atraksion tërheqës për qëndrim (pushim dhe rekreacion) të njerëzve në natyrë duke ndikuar në mirëqenien shëndetësore të njerëzve dhe përfitimet ekonomike të rajonit dhe Kosovës si rezultat i zhvillimit të turizmit. Ndërtimi i ashtuquajturit „fshatit turistik” dhe shkatërrimi i konsiderueshëm të natyrës do të ndikojë në humbjen e vlerave estetike (bukurisë) të natyrës si dhe vlerave turistike pasi që humbin arsyet (bukuria natyrore) tërheqëse të natyrës për vizitorët dhe zhvillimin e turizmit (me humbjen e vlerave estetike të natyrës humbin edhe vlerat turistike).

•Humbja e vlerave ekologjike, edukativo-arsimore dhe shkencore të Prevallës

Shkatërrimi i natyrës (biodivëzitetit, florës, faunës dhe bashkësive të tyre) dhe humbja e vlerave burimore, estetike, hidrologjike, peisazhore të natyrës ndikojnë drejtpërdrejt në humbjen e vlerave ekologjike, edukativo-arsimore dhe shkencore të Prevallës. Me shkatërrimin e natyrës përgjithmon humbet funksioni ekologjik i saj që nënkupton prodhimin e oksigjenit, asgjësimin e dioksid karbonit, rregullimin e regjimit të ujrave, pastrimin e ajrit dhe ujrave, prodhimin e biomasës (masës drunore, frutave, këpurdhave, bimeve, shtazëve etj.), rregullimin e mikroklimës, mbrojtjen nga erozioni, etj. Natyra e shkatërruar nuk paraqet objekt interesant dhe tërheqës për hulumtime shkencore dhe aktivitetet edukativo-arsimore të qytetarëve etj.

•Ndotja e mjedisit (tokës, ajrit dhe ujrave)

Një fshat me mbi 360 shtëpi në zemër të zonës së mbrojtur natyror të Parkut nacional paraqet burim të përhershëm i ndotjes së pakontrolluar të mjedisit (tokës, ajrit dhe ujit) nga ujrat e zeza, emitimi i gazrave toksike dhe pluhurit, hudhja e mbeturinave etj. Çdo person i rëndomtë (nuk ka nevoj të jetë ekspert i natyrës) mund të paramendojë se çfarë çrregullime katastrofike ekologjike dhe ndotje të mjedisit do të shkaktojnë 360 oxhakë me tym, 360

depo mbeturinash, 360 WC me ujra të zeza, 360 automjete me CO₂, prerja e 360 drunjëve (së paku nga 1 dru për çdo objekt) për ngrohje etj.

Këto janë vetëm disa pasoja katastrofike natyrore dhe ekologjike të ashtuquajturit Plani rregullativ urban „Prevalla”. Duhet theksuar se PRRU „Prevalla”, për shkak se synon shkatërrimin e konsiderueshëm të natyrës (17 ha), nuk mund të zbatohet as jashtë territorit të Parkut nacional.

Dëmet dhe parregullësit e ashtuquajturit „kampingut veror” në Prevallë

Punimet tokësore, hapja e rrugëve, ndërtimet dhe vendosja pa plan dhe pa kontroll të objekteve në ashtuquajturin „kampingu veror” në Prevallë kanë ndikuar në shkatërrimin e natyrës së mbrojtur me ligj të PN në sipërfaqe prej afro 2 ha. Në kuadër të këtij „kampingu”, përveç shkatërrimeve masive të natyrës, janë verifikuar edhe veprime të shumta të kundërligjshme, siç janë:

- *Ndërtimet ilegale të objekteve* - Numri i pergjithshëm i objekteve ilegale nga druri dhe konstruksioni i hekurit që janë ndërtuar gjatë viteve 2007-2008. është mbi 50.
- *Uzurpimi i tokës shtetërore* - kampingu veror parasheh vendosjen e kamp-shtëpizave dhe tendave vetëm gjatë sezonës verore (vet fjala „kampingu veror” e vërteton këtë), ndërsa objektet (kamp shtëpizat, kontenierët dhe ndërtimet ilegale) qëndrojnë në territorin e Parkut nacional gjatë gjithë vitit. Ndërtimi i objekteve ilegale në pronën shtetërore dhe vendosja dhe qëndrimi i objekteve të tjera (kamp shtëpizave, kontenierëve etj.) gjatë gjithë vitit në tokën shtetërore të PN (Prevallës) paraqet vepër të kundërligjshme (penale) - uzurpimin e pronës shtetërore.
- *pagesat e kundërligjshme* - firma private që e menaxhon „kampingun veror” ka kryer pagesa për vizitorët të cilin kanë objekte të vendosura apo të ndërtuara ilegalisht në vlerë prej 720 € për një vit (informata duhet të konfirmohet) dhe nga 1 € për hyrje të automjeteve gjatë ditëve të uikendit. Mjetet që realizohen nuk paguhet fare në buxhetin e PN dhe të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Është e kundërligjshme dhe e palogjikshme që të shfrytëzohet pasuria shtetërore e PN, ndërsa shteti të mos këtë përfitime financiare, por përkundrazi është duke pësuar vetëm dëme natyrore dhe buxhetore.

Këto veprime në zonën e mbrojtur me Ligj të Parkut nacional kanë pasoja shkatërruese ekologjike, ekonomike dhe sociale për PN dhe Republikën e Kosovës.

3.4. Shfrytëzimi i sipërfaqeve barishtore

Shfrytëzimi i kullosave është i kufizuar si pasojë e zvogëlimit drastik të numrit të bagëtive në rajonet ku shtrihet territori i Parkut nacional. Kullosat shfrytëzohen kryesisht në mënyrë sezonale gjatë periudhës maj-shtator nga blegëtorët e rajonit të Prizrenit dhe banorët lokal. Në territorin e PN-së, gjatë sezonës verore të këtij viti, në kullosat e maleve të larta kanë qenë të pranishme afro 2500 bagëti të imëta (dele) dhe 130 lopë në Gurin e Zi.

Në këtë vit kullosat e PN janë shfrytëzuar kryesisht në mënyrë ilegale (8 blegëtorë, 5 në Prevallë, 1 në Konjushkë, 1 në Gurin e Zi dhe 1 në Virovi, nuk i kanë pasur kontratat për shfrytëzim), ndërsa vetëm një blegëtor i ka kryer obligimet ndaj PN. Kjo është pasojë e keqmenaxhimit të ish drejtorit të PN ku si pasojë janë shkaktuar PN dëmë të konsiderueshme ekologjike (dëgradimi i ekosistemeve barishtore) dhe ekonomike (është dëmtuar buxheti i PN dhe i Republikës së Kosovës pasi që mjetet nuk paguhet në

buxhetin shtetëror). Duhet theksuar se blegëtorët që i kanë shfrytëzuar në mënyrë ilegale kullosat e PN kanë shkaktuar edhe tre zjarre në kullosat dhe shkurret e dëllinjave në malin Konjushkë, me qëllim të zgjerimit të sipërfaqeve për kullosat dhe përmirësimit të strukturës së kullosave (barit).

Shfrytëzimi i kullosave në PN në të kaluarën ka ndikuar në paraqitjen e disa pasojave negative në mjedisin natyror, në kuadër të cilëve veçohen:

- Ndryshimi i përbërjes së vegjetacionit barishtor në vendet (tëbanët) ku kanë qëndruar bagëtitë. Në këto vende vërehet zhvillimi dominues i hithrit (*Urtica dioica*) dhe *Rumex* sp.
- Mungesa e ripërtëritjes së pyjeve në pjesët që kufizohen me kullosat si pasojë e dëmtimit të filizërisë nga bagëtia, gjë që ka ndikuar së bashku me prejern në kufiri i vegjetacionit pyjor të bjerë më poshtë,
- Dëmtimi i pyjeve nga blegëtorët të cilit për nevojat e ngrohjes kanë bërë prerje të drunjëve të njoma duke ndikuar në degradimin e pyjeve,
- Shkaktimi i zjarreve pyjore, në veçanti në pyjet e rrobullit, si pasojë e pakujdesisë së blegëtorëve apo qëllimisht për të zgjeruar sipërfaqen e kullosave në zonat të cilët i kanë pëlqyer për nevojat personale të tyre.

Duhet theksuar së shumica sipërfaqeve barishtore në arealin e pyjeve (kullosat pyjore) që gjenden në Prevallë, Gurin e Zi, Ujrat e Gropuar, Gradancë dhe Kroni i Mbretit (Guri i Dellocit) janë shfrytëzuar për qëndrimin e vizitorëve në natyrë gjatë stinës verore, ku si pasojë e parkimit e automjeteve dhe hedhjes së mbeturinave janë shkaktuar dëmtime dhe ndotje të natyrës. PN, përveç dëmeve ekologjike, ka pasur edhe humbje të konsiderueshme financiare pasi që nuk i lejohet që të aplikojë pagesat (taksat) për shfrytëzimin e territorit dhe pasurive të PN nga vizitorët.

4. GJENDJA E BOTËS BIMORE (FLORËS)

Parku nacional është i pasur me shumëllojshmëri e bimëve (posedon mbi 2500 lloje) të cilët formojnë 112 fitocenoza (bashkësi bimore). Bimet nga aspekti i morfologjik (formës së habitusit) dhe ndërtimit të brëndshëm diferencohen në llojet drunore dhe barishtore, ndërsa nga aspekti i përhapjes (pranisë) ndahen në llojet me përhapje të gjërë (kosmopolite) dhe llojet e rralla endemike me përhapje dhe prani të kufizuar. Rëndësi të veçantë kanë 323 bimë endemike, në kuadër të cilëve veçohen 20 lloje stenoendemike që gjenden vetëm në vendet e kufizura në territorin e Parkut nacional.

4.1. Gjendja e llojeve endemike drunore

Gjendja më vështirë shëndetësore paraqitet të lloji i pishës endemo-relikt të rrobullit si pasojë e dëmeve të mëdha të shkaktuara nga zjarri dhe zhvillimi i insekteve dëmtues – nëlivoresve të pishës të cilit ndikojnë në tharjen e bashkësive pyjore *Pinetum heldreichii* në rajonet e Koxha Ballkanit dhe Oshlakut. Rrobulli përveç bashkësive të pastra, krijon edhe bashkësi të përziera me ahun, bredhin dhe hormoqin në Koxha Ballkan dhe Pashallare, në kuadër të cilëve gjendja e tij paraqitet më e mirë. Më gjërësiht për gjendjen e bashkësive pyjore të rrobullit është përshkruar në kuadër të gjendjes së ekosistemeve pyjore.

Gjendja e llojeve të tjera të rralla drunore siç janë: arneni (*Pinus peuce*), dredhaku (*Pinus mugo*), panja malore (*Acer heldreichii*) dhe tisi (*Taxus baccata*) është relativisht e mirë.

Panja malore dhe tisi zhvillohen, kryesisht, në kuadër të bashkësisë pyjore të ahut dhe bredhit (Abieti-fagetum) në Njësinë ekonomiko-menaxhuese „Malet e Mushtishtit” dhe kanë përhapje tejet të kufizuar. Ripërtëritja e këtyre dy llojeve të rralla drunore është e vështirësuar si pasojë e zhvillimit të drunjëve tjera (ahut dhe bredhit) të cilit ndikojnë në ngushtimin (zvoglimin) e hapësirës për zhvillimin e këtyre llojeve drusore.

Dredhaku dhe arneni kanë përhapje më të gjërë, në krahasim me dy llojet e lartpërmendur, dhe krijojnë bashkësitë e veta pyjore Pinetum mughi në Pashallare dhe Koxha Ballkan dhe Pinetum peucis në zonën e Bistrës (rajoni i Prevallës). Arneni gjendet edhe në Pashallare në kuadër të pyjeve të përziara të rrobullit, hormoqit dhe bredhit, ndërsa gjatë 10 viteve të fundit vrehët zhvillimi i tij në pjesët e larta veri-perendimore të Koxha Ballkanit dhe Oshlakut. Gjendja shëndetësore e arnenit dhe dredhakit është mirë, mirëpo ripërtëritja e tyre, në veçanti të dredhakit, është e kufizuar.

Nga bimët e tjerë shkurre e rrezikuar është edhe boronica si pasojë e mbledhjes së frytave të saja me pajisje metalike me çrast dëmtohet bima dhe pengohet zhvillimi normal i saj.

4.2. Gjendja e bimëve endemike barishtore

Gjendja e bimëve të rralla barishtore, të cilët i japin vlerë të veçantë florës së Parkut nacional, është e mirë dhe e qëndrueshme. Këto bimë gjenden kryesisht në zonat më të larta (mbi 2000 m) të Parkut nacional dhe janë pjesë përbërëse të kullosave të maleve të larta. Në ruajtjen e tyre kanë ndikuar këta faktor:

- Zonat malore ku gjenden këto bimë nuk frekventohen nga njerëzit të cilët në shumicën e rasteve, në vendet ku kanë deportuar, e kanë bërë degradimin e ekosistemeve natyrore.
- Zvoglimi drastik i numrit të bagëtive pas vitit 1999. që ka ndikuar në kufizimin e shfrytëzimit të kullosave të Parkut nacional,
- Ndalimi i shfrytëzimit të kullosave në zonat e pasura me bimë endemike nga Administrata e PN-së,
- Monotorimi i vazhdueshëm i gjendjes së bimëve endemike nga DPN.

Nga llojet që kanë vlerë të veçantë për Parkun nacional, janë verifikuar në gjendje të mirë këto bimë stenoendemike: bar pezmi i mbretit aleksandër (*Achillea alexandris regis*) në Oshlak, bormylera e Dieckit (*Brunmullera dieckii*) në Pashallare, krokusi i Sharrit (*Crocus scardicus*), karafili i Sharrit (*Dianthus scardicus*), zambaku shqiptar (*Lilium albanicum*) në malin Sharr etj.

Për shkak të kushteve të vështira klimatike dhe dendësisë së llojeve të tjera bimore, në veçanti të llojeve të barit (*Graminea*), rigjenerimi i bimëve endemike është i vështirësuar. Kjo ka ndikuar në kufizimin e përhapjes së tyre të cilët gjenden vetëm në vendet caktuara të Parkut nacional. Për të siguruar mbrojtjen dhe zhvillimin më të mirë të bimëve endemike, parashtrahet nevoja e shpalljes së zonave të pasura me këto bimë si rezervate strikte të natyrës dhe përpilimit të Planit menaxhues afatgjatë (Programit për mbrojtjen dhe zhvillimin e resurseve natyrore) të Parkut nacional. Përshkrimi i zonave që janë propozuar për shpallje si rezervate strikte të natyrës janë përshkruar në pikën 8: Zonimi i PN.

Disa lloje të rralla të bimëve mjekuese janë objekt i shfrytëzimit ilegal nga njerëzit të papërgjegjshëm. Bima më e rrezikuar është sanëza (*Gentiana lutea*) e cila mblidhet nga banorët lokal dhe personat e ndryshëm që e përdorin për tregëti (përfitime personale) pa si që ajo ka vlera të veçanta mjekuese. Sanëza gjendet në pjesët më të larta (mbi 2000 m) të territorit të Parkut nacional, nërkaq si pasojë e shfrytëzimit të pakontrolluar në të kaluarën mbijetesa e saj është mjaftë e rrezikuar. Në këtë vit tentime për mbledhje ilegale të kësaj bime kanë qenë të kufizuara për shkak të shtimit të kontrollave të terreneve nga DPN në lokacionet ky ajo është e pranishme.

5. GJENDJA E BOTËS SHTAZORE (FAUNËS)

Gjendja e faunës në PN, duke marr parasysh gjendjen ekonomiko-sociale dhe nivelin e vetdijimit të qytetarëve si dhe mungesën e zbatimit të ligjeve, mund të vlerësohet si e mirë. Duhet theksuar se në vitin 2002 kur ka filluar të funksionoj DPN gjendja e faunës ka qenë e rëndë si pasoj e luftës 1999. dhe gjuetisë ilegale e cila është shfaqur më intenzitet të lartë pas luftës. Këto faktor kanë ndikuar në zvogëlimin e dukshëm të kafshëve të egra, në veçanti të atyre që janë atraktive për gjueti: kaprojve dhe dhijve të egra. Duhet theksuar se gjendja e kafshëve të egra është përmirësuar pas formimit të Drejtorisë së Parkut nacional në kuadër të MMPH-së, me çrast këto resurse natyrore e kanë marrë mbrojtjen më të mirë institucionale. Kjo ka ndikuar në zhvillimin dhe rritjen e vazhdueshme të numrit të kafshëve të egra, në veçanti të ariut të murrëm, kaprojve dhe dhive të egra. Nga gjurmimet e bëra në terren janë verifikuar shumica e kafshëve të egra që janë regjistruar nga hulumtimet e mëherëshme, ndërsa shënimet për disa lloje më të rëndësishme të PN janë paraqitur në tabelën vijuese:

Tabela 2: Gjendja e kafshëve të egra në PN (KK të Prizrenit dhe Suharekës) për vitin 2008

Lloji i kafshës së egër	Gjendja e fondit në fillim të vitit	Reprodukimi (zhvillimi) vjetor	Humbjet (natyrore etj.)	Gjendja e fondit në fund të vitit
Airu i murrëm	22	7	1	28
Kaprolli	40	10	3	47
Reqëbulli	4	-	-	5
Dhija e egër	170	38	10	198
Derri i egër	50	25	15	60
Lepuri	130	60	40	150
Ujku	9	6	4	11
Shiponja e përhimtë	4	-	-	4
Fllëza e gurëve	150	50	30	170

Nga tabela e paraqitur mund të vërehet se numri i shumicës së kafshëve është në rritje në karahasim në vitin e kaluar, mirëpo numri disa kafshëve të egra si reqëbulli dhe shqiponja e përhimtë është mjaftë i vogël dhe nuk tregon rritje. Shumica e llojeve të gjitarëve, të cilët kanë qenë të regjistruar në hulumtimet e mëparshme janë verifikuar në terren, mirëpo, për përcaktimin e numrit të tyre nevojiten gjurmimet më intenzive në të gjitha rajonet e Parkut nacional. Nga llojet e faunës që kanë qenë të pranishme në vitet e 80-a nuk janë verifikuar pulegra e madhe (*Tetrao urogalis*) dhe lundërza (*Lutra lutra*) që jep të kuptohet se numri i tyre është mjaftë i vogël apo ndoshta edhe janë zhdukur nga vendbanimet e mëparshme si

pasoj e deportimit, çdo ditë e më shumë, të njerëzve në vendbanimet e tyre. Shumë prej kafshëve të egra, siç janë ariu i murmë, ujku, reqëbulli, dhelpra, lepuri, derri i egër, kaprolli etj. migrojnë në pjesët e ndryshme të Parkut nacional dhe jashtë territorit të PN-së në kërkim të ushqimit.

Gjendja shëndetësore të kafshëve të egra është e mirë (nuk janë vërejtur kafshë të sëmura apo të ngordhura), ndërkaq rrezikun e vazhdueshëm për kafshët e egra paraqet gjuetia ilegale nga njerëzit të pandërgjegjshëm, shumica e të cilëve e shfrytëzojnë anëtarësinë në shoqatat e gjahtarëve për veprime ilegale. Vendet më të rrezikuara nga gjuetia ilegale, e cila shfaqet kryesisht gjatë ditëve të vikendit, janë: Ujrat e Gropuar, Oshlaku, Konjushka, Vrtopi dhe Rusenica. Llojet më të rrezikuara nga gjuetia ilegale janë dhija e egër dhe kaprojtë, ndërsa gjahtarët ilegal nuk i shmangen edhe vrasjeve të kafesëve të tjera, në veçanti të ariut të murmë, nëse ju paraqitet rasti.

Riprodhimi natyror i shumicës së kafshëve të egra është e mirë, në veçanti të ariut të murmë i cili në PN ka zhvillim mjaftë të mirë.

6. GJENDJA E REZERVATEVE STRIKTE NATYRORE

Në territorin e Parkut nacional gjenden 4 rezervate strikte natyrore:

1. *Popovo prase*: rezervati natyror i pyjeve të pastërta të rrobullit (*Pinetum heldreichi*) në ekspozicionin jugor të malit Oshlak në Prevallë, me sipërfaqe prej 30 ha, është vënë në mbrojtje me 9 dhjetor 1960. nga KK i Prizrenit, në pronësi shtetërore.

2. *Pisha e Madhe*: rezervati natyror i pyjeve të pastërta të rrobullit (*Pinetum heldreichi*) në ekspozicionin jugor të malit Koxha Ballkan, me sipërfaqe prej 35 ha, është vënë në mbrojtje me 9 dhjetor 1960. nga KK i Prizrenit, në pronësi shtetërore.

3. *Pisha e Madhe*: rezervati natyror i pyjeve të pastërta të rrobullit (*Pinetum heldreichi*) në ekspozicionin perëndimor të malit Oshlak, me sipërfaqe prej 20 ha, është vënë në mbrojtje me 9 dhjetor 1960. nga KK i Prizrenit, në pronësi shtetërore.

4. *Rusenica*: rezervati natyror - vendbanimi i rreqebullit (*Lynx lynx*) në Grykën e Rusenicës (KK Suharekë) me sipërfaqe prej 300 ha, është vënë në mbrojtje me 11 tetor 1955. në pronësi shtetërore.

6.1. Gjendja e rezervateve të pyjeve të rrobullit (*Pinetum heldreichi*)

Gjendja e rezervateve strikte natyrore të pyjeve të rrobullit - *Pinetum heldreichii* (Popovo prase, Pisha e madhe dhe Oshlaku) janë pëshkruar në pikën 2.2: Gjendja e ekosistemeve pyjore.

6.2. Rezervati natyror Rusenica (vendbanimi i rrëqebullit)

Rusenica është rezervati më i vjetër natyror i shpallur në vitin 1955. me qëllim të mbrojtjes së rrëqebullit. Në fillim të viteve 90-a në këtë rezervat janë numruar 13 kafshë të tilla, mirëpo, gjatë viteve të fundit është vërejtur migrimi i rrëqebullit në pjesët e ndryshme të Parkut Nacional si pasoj e kërkimit të ushqimit dhe pranisë së shtuar të njeriut në vendbanimet e tij.

Rusenica karakterizohet me shkëmbinjtë gelqërore dhe dy bashkësi pyjore: pyjet e ahut dhe bredhit (Abieti-Fagetum) dhe pyjet e ulta të mullezës dhe frashnit të zi (Orno-Ostryio carpinetum). Gjendja e vegjetacionit pyjor është e vështirë si pasoj e pranisë së numrit të madhë të drunjëve të vjetruar të ahut dhe bredhit të cilit paraqesin bazë të përshtatshme për zhvillimin e dëmtuesve fitopatologjik dhe entomologjik. Në këta drunjë është vërejtur paraqitja e disa patogjeneve dhe insekteve siç janë:

- tumori i lëvorës në trungjet e ahut dhe bredhit,
- kërpudha parazite Fomës fomentarius (shkaktari i kalbjes në trungjet e ahut)
- kërpudha parazite Armillaria mellea (shkaktari i kalbjes në trungjet e bredhit),
- nënlëvorësit e bredhit Curvidens sp. (insektet dëmtues në trungjet e vjetruara të bredhit)

Ripërtëritja natyrore në bashkësinë pyjore të ahut dhe bredhit është mjaftë e shprehur. Në veçanti është e pranishme filizëria e shumtë e bredhit e cila e dominon filizërin e ahut. Ky lokacion është i rëndësishëm edhe nga aspekti floristik ku nga llojet e tjera bimore duhet veçuar praninë e llojeve endemike: burnumullera (Burnumullera dieckii), panja e maleve (Acer heldreichii), Ramondia serbica etj. Vegjetacioni barishtor është i pasur me llojet mezofile në pyjet e ahut dhe bredhit dhe llojet kserofite në pyjet e mullezës dhe frashnit të zi.

Gjendja e rezervatit natyror të Rusenicës sëhtë e vështirë si pasoj e ndikimit negativ të njeriut që shfaqet në tre mënyra:

- prerjet ilegale të pyjeve në pjesët kufitare të rezervatit natyror,
- shfrytëzimi i gurit në hyrje të Grykës së Rusenicës i cili bëhet me minim (eksploziv),
- gjuetia ilegale e cila shfaqet koh pas kohe.

Në pasojat katastrofike ekologjike në veçanti ka ndikuar shfrytëzimi i gurit, që shprehen në mënyra të ndryshme:

- shkatërrimi i pyjeve dhe tokave pyjore në sipërfaqe prej afro 1 ha,
- krijimi i zhurmës, pluhurit dhe vibracioneve si pasoj e minimumit të terrenit dhe shfrytëzimit të vazhdueshëm të gurit me mekanizim të rëndë (esakvator, kamion etj.),
- shkatërrimi dhe ndryshimi total i peisazhit të mbrojtur të rezervatit natyror, etj.
- largimi (migrimi) i shumicës së kafshëve të egra, në veçanti të rrëqebullit, si pasoj e pranisë së njeriut dhe shqetësimeve të vazhdueshëm në zonë.

Duhet theksuar së shfrytëzimi i gurit në PN, e në veçanti në rezervatet strikte të natyrës, është rreptësisht i ndaluar me Ligjet e Republikës së Kosovës (LPN, LMN, LMM etj.), Kodin e Përkohshëm Penal dhe konventat ndërkombëtare të KB dhe BE-së (IUCN, etj.)

7. GJENDJA E RESURSEVE UJORE

Parku nacional „Malet e Sharrit” është i pasur me burime të shumta të ujit të cilët formojnë prrocka, lumej dhe liqej që këtij Parku i japin vlerë të jashtëzakonshme natyrore. Lumejtë më të rëndësishëm janë Lepenci, i cili i takon pellgut të Egjeut, dhe Lumbardhi i Prizrenit që i takon pellgut të Adriatikut, ndërsa liqejtë më të veçanta janë ata të Livadhishtës, Jazhincës dhe Katundit të Epërm të cilit gjenden në lartësinë mbidetare mbi 2000 m.

Gjendja e resurseve ujore është vështirësuar si pasoj e shfrytëzimit të pakontrolluar të tyre. Shumë prej burimeve të ujit janë dhënë (uzurpuar) në shfrytëzim pa kriteret ligjore dhe pa u pytur DPN, ashtu që autoktoniteti i këtyre burimeve dhe peisazheve që i rethojnë ato dukshëm është dëmtuar dhe ndryshuar. Në këtë vit, gjatë periudhës prill-qershor, ndërhyrje në burimet ujore ka pasur në rajonin e Prevallës dhe Drajçiqit me çrast, përveç dëmeve në burimet ujore, janë degraduar edhe sipërfaqet barishtore si pasoj e punimeve tokësore në ndërtimin e ujësjellësve. Këto punime janë ekzekutuar pa mbikqyrjen e DPN dhe sipas dëshirave të njerëzve të caktuar, ndërsa në dëm të vlerave natyrore të PN.

Si pasoj e mungesës së të reshurave gjatë pranverës dhe verës si dhe temperaturave të larta që kanë mbizotruar gjatë këtij viti, sasia e ujit në prrocka, lumej dhe liqej dukshëm është zvogluar. Gjithashtu është regjistruar edhe tharja e shumë burimeve të ujit, gjë që nuk ka ndodhur në të kaluarën. Gjendja në aspektin e sasisë së ujit është përmirësuar në fund të vitit, gjatë muajve dhjetor dhe nëntor, si pasoj e reshjeve të bollshme që kanë qenë, kryesisht, në formë të shiut.

8. SHFRYTËZIMI I RESURSEVE NATYRORE (ZHVILLIMI I VEPRIMTARIVE KOMERCIALE) NË TERRITORIN E PARKUT NACIONAL

Mbrojtja e resurseve natyrore paraqet funksionin kryesor të Parkut nacional, mirëpo, në gjithë territorin e Parkut nacional nuk aplikohet regjimi strikt i mbrojtjes. Mbrojtja nuk nënkupton ndalimin e shfrytëzimit të resurseve natyrore, por që shfrytëzimi të bëhet në përputhje me funksionin e mbrojtjes dhe në pajtim me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës. Regjimi i mbrojtjes dhe mënyra e shfrytëzimit të resurseve natyrore të Parkut nacional, duke u bazuar në vlerat natyrore, përcaktohet me zonimin e territorit të Parkut nacional (Planin Hapësinor), që nënkupton ndarjen e territorit të PN-së në zonat e caktura (së paku 3 zona) sipas shkallës së mbrojtjes dhe destinimit. Vepritarit komerciale janë të ndaluara rreptësisht vetëm në zonën e parë të mbrojtjes ndërsa në zonat e dytë dhe të tretë të mbrojtjes lejohen aktivitetet e kufizura në përputhje me Planin Hapësinor dhe Planin menaxhues të PN.

Të gjitha veprimtaritë në vitin 2008, në veçanti gjatë periudhës janar-qershor, që janë zhvilluar në territorin e PN kanë qenë të kundërligjshme (ilegale) dhe jashtë mbikqyrjes së Drejtorisë së PN. Nga këto aktivitete ilegale veçohen:

- Shfrytëzimi i gurit në rezervatin strikt të natyrës „Rusenica” me anë të minimit (eksplozivit). Parku nacional, përveç dëmeve të konsiderueshme ekologjike, ka pësuar edhe dëme ekonomiko-financiare pasi që nuk janë paguar taksat për shfrytëzimin e gurit. Kush përfiton nga ky veprim ilegal, përveç firmës që e shfrytëzon gurin, nuk dihet.
- Shfrytëzimi i gurit në Oshlak nga firma private e Mushnikovës. Shfrytëzimi i gurit në këtë lokacion, në krahasim me Rusenicën, ka qenë me intenzitet më të ulët dhe është bërë pa minime. Edhe përkundër intervenimeve të vazhdueshme të punëtorëve të PN dhe inspektionit të MMPH-së shfrytëzimi i gurit ka vazhduar.
- Shfrytëzimi i kullosave nga 8 persona (blegëtorë) në vendet: Toshovicë, Prevallë, Konjushkë, Guri i Zi dhe Virovi të cilit edhe përkundër të vërejtjeve nga punëtorët e PN (kujdestarëve dhe ekipeve mbikqyrëse) nuk i kanë përmbushur obligimet ndaj PN. Arsyeja e vetme e tyre për moskryerjen e obligimeve ndaj DPN ka qenë se ata kanë biseduar (e kanë kryer punën) me ish drejtorin.
- Zhvillimi i turizmit në rajonin e Prevallës ku janë duke u kryer dy projekte kontestuese (kundër ligjore) nga KK i Prizrenit: ndërtimi i fshatit turistik dhe kampingut veror. Drejtorisë së PN janë marr, në kundërshtim me Ligjet e PN, MN dhe MM, kompetencat menaxhuese ndaj resurseve natyrore në Prevallë, ku si pasoj, përveç dëmeve të konsiderueshme ekologjike, PN dhe Buxheti i Republikës së Kosovës kanë pësuar edhe dëme ekonomike, pasi që nuk paguan taksat për kampingun, hyrjen në brendësi të territorit të PN etj. Të gjitha mjetet nga shfrytëzimi i territorit dhe resurseve natyrore të PN i ka realizuar firma private që menaxhon me ashtuquajturin „kampingu veror”.

- Zhvillimi i tregëtisë në Prevallë ku janë vendosur 5 objekte tregëtare të përkohëshme, ndërsa gjatë verës veprojnë shumë tregëtarë tjerë dhe lodra rrotulluese („ringishpill”), pronarët e të cilëve nuk e kanë pasur lejen e Drejtorisë së PN.
- Zhvillimi i turizmit në Gradancë (rajonin e Mushtishtit) ku pas vitit 2005. janë ndërtuar mbi 40 objekte ilegale edhe për kundër vërejtjeve të DPN, ku qëndrojnë banorët e Mushtishtit gjatë stinës verore. Duhet theksuar se vizitorët në Gradancë janë të gatshëm për të paguar taksat e caktuara për shfrytëzimin e territorit të PN, mirëpo ky shërbim dhe kompetencë që i takon DPN-së ende nuk lejohet të kryet. Në afërsi të rajonit të Gradancit, në vendin Kroni i Mbretitit gjenden edhe 5 objekte të ndërtuara në mënyrë ilegale pas vitit 1999. që shfrytëzohen gjatë verës nga disa familje nga fshati Bukosh.
- Mbledhja e boronicave dhe dëllinjave në rajonin e Zhupës nga banorët lokal dhe vizitorët në Prevallë. Këto frute pyjore janë grumbulluar nga disa firma private të cilët plotësisht i kanë injoruar punëtorët e DPN duke u shmangur identifikimit dhe kryerjes së obligimeve ligjore, gjegjësisht marrjes së lejes për ushtrimin e veprimtarisë në territorin e PN.
- Shfrytëzimi i objektit të PN nga vizitorët në Ujrat e Gropuar. Shpesh herë ka ndodhur që këtë objekt ta shfrytëzojnë edhe personat që dyshohen për gjueti ilegale, zakonisht ditëve të uikendit. Kujdestari i PN që e ka në përgjigjësi këtë objekt nuk e ka mbajtur evidencën e vizitorëve që kanë qëndruar në objekt, nuk ka raportuar për shfrytëzimin e këtij objekti dhe as nuk i ka paraqitur mjetet eventuale të reazliuara nga shfrytëzimi i këtij objekti.
- Shfrytëzimi (uzurpimi) i disa burimeve të ujit gjatë periudhës prill-qershor, në rajonet e Prevallës dhe Drajçiqit pa lejen dhe mbikqyrjen e DPN. Kush nga personat zyrtar apo institucionet lokale apo qendrore janë involuvar në këto veprime të kundërligjshme në PN nuk dihet.

Duhet theksuar se pas dorëheqjes së ish drejtorit dhe vendosjes së drejtorit të ri në DPN dukshëm është përmirësuar mbrojtja e resurseve natyrore nga vepritaritë e kundër ligjshme në territorin e PN. DPN ka filluar procedurën në MMPH për ndalimin e shfrytëzimit të gurit dhe janë ndërmarr aktivitetet për vendosjen e rregullave ligjore në aspektet ndërtimore, në veçanti në Prevallë dhe Brezovicë.

9. ZONIMI I PARKUT NACIONAL

9.1. Përshkrimi i zonimit të PN

DPN, në bashkëpunim me IPH dhe AKMN, në bazë të projektit që ka filluar të zbatohet vitin e kaluar (2007) në këtë vit ka vazhduar aktivitetet në zonimin PN për nevojat e hartimit të Planit Hapësinor, me çrast janë kryer punët profesionale siç janë:

- hulumtimi i vlerave natyrore të PN në malet Koxha Ballkan, Oshlak dhe Sharr,
- propozimi i zonave të I, II dhe të III të mbrojtjes dhe përcaktimi i kufijve të këtyre zonave,
- përgatitja e hartave dhe raporteve për zonimin e PN etj.

Në bazë të vlerave natyrore të verifikuara në terren, ekipi profesional i MMPH (DPN, IPH dhe AKMN) ka propozuar, përveç katër rezervateve ekzistuese, shpalljen edhe 10 zonave të tjera si zona të I të mbrojtjes, respektivisht si rezervate strikte të natyrës, dhe atë:

- Kopilica, Dupnica dhe Lumbardhi në territorin e KK të Prizrenit
- Bistra, Prrocka e Durlës, Livadhishte dhe Gryka në territorin e KK Shtëprcë,
- Pashallare dhe Lendina e Gjatë në territorin e KK të Suharekës dhe
- Luboteni në territorin e KK të Kaçanikut.

9.2. Zonat e II (e dytë) të mbrojtjes

Si zonë e II e mbrojtjes janë propozuar:

- të gjitha pyjet jashtë rezervateve strikte të natyrës,
- ekosistemet barishtore që i rrethojnë zonat strikte të natyrës (buffer zona),
- ekosistemet barishtore që karakterizohen me biodiversitet (shumëllojshmërinë e llojeve bimore) të pasur dhe që gjenden në terrenet e pjerrëta të rrezikuara nga erozionet.

Në zonën e dytë të mbrojtjes lejohen vetëm ndërhyrjet e kufizuara profesionale nga aspekti sanitar, gjegjësisht tekniko-biologjik.

9.3. Zona III (e tretë) e mbrojtjes (zona për turizëm dhe urbanizim):

Si zonë e III e mbrojtjes janë propozuar zonat e sipërfaqeve barishtore që janë destinuar për kullosa, zhvillimin e turizmit, aktivitetet sportive-rekreative dhe ndërtimin e objekteve turistike si dhe pronat private (livadhet) të komunitetit lokal që gjenden afër fshatrave që kufizohen me territorin e Parkut nacional.

- **Zonat për kullosa janë:**

- *Guri i Zi* (rajoni i Struzhës)
- *Vrtop* (rajoni i Manastericës)
- *Maja e Vogël* (rajoni i Draçiqit)
- *Konjushkë* (rajoni i Mushnikovës)
- *Mali i Vogël* (rajoni i Katundit të Epërmë)
- *Guri i Bardhë, çuka e Zezë, Glavnishtë* (rajoni i Shtërpcës)
- *Dëllinjët e djegura* (rajoni i Gotovushës)
- *Tëbanët e Ibrahimit* (rajoni i Firajes)
- *Tëbanët e Brodit* (rajoni i Brodit)
- *Virovi* (Rajoni i Planjanës)
- *Bjeshkët a Kabashit* (Rajoni i Kabashit dhe Korishës)
- *Guri i Dellocit* (Rajoni i Dellocit)
- *Tëbanët e Bukoshit* (Rajoni i Bukoshit dhe Maçitevës)

Këto zona të propozuara për kullosa mund të shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive nga komuniteti lokal dhe blegëtorët sezonal që zakonisht i shfrytëzojnë kullosat e maleve të larta gjatë periudhës maj-shtator. Plani menaxhues për çdo zonë do të përcakton kapacitetet shfrytëzuese (numrin e bagëtive) me qëllim që ndikimi i shfrytëzimit të kullosave të këtë pasoja minimale në biodiversitet dhe zhvillimin e bimëve barishtore.

- **Zonat për zhvillimin e aktiviteteve sportive-rekreative dhe ndërtim turistik**

- *Guri i Zi* (KK Prizren)-zona për zhvillimin e turizmit dimëroro-sportiv dhe uikendo-piknik. Propozohet ndërtimi i qendres turistike me objekte kapitale turistike-hotele dhe motele.
- *Prevala* (KK Prizren)-zona për zhvillimin e turizmit stacionar gjatë stinave verore dhe dimërore, turizmit uikendo piknik dhe turizmit tranzitor. Në këtë zonë për ndërtim turistik janë propozuar këto lokacione:

„Fierishte” (Papraxhina)- për ndërtimin e objektit turistik-shëndetësor (sanatorium), *Parcelat private prej 167 deri 181/2*. (në anën e djathtë të rrugës Prizren-Shtërpçë) - për ndërtimin e kufizuar të uikend shtëpizave.

„Shtëpia malore” (parcela pyjore 97) - për rregullimin e kampingut veror për vendosjen e objekteve të përkohshme turistike (kamp shtëpizat dhe tendat) gjatë stinës verore.

Lokacioni përreth restorantit „Eja” (parcelat: 131/1; 131/2; 132; 133; 134/1; 134/2; 135; 135/1; 135/2; 136; 137; 138; 139/1; 139/2; dhe 143.- për ndërtimin e hotelit me parkingun qendror dhe objektet e tjera përcjellëse turistike, infrastrukturore dhe sportive.

Duhet theksuar se këto zona për ndërtimin turistik në Prevallë janë përcaktuar gjatë zonimit të rajonit të Prevallës në vitin 2007. (shiko Raportin për zonimin e Prevallës nr. 07/1742/1 të datës 09.08.2007.)

- **Brezovica** (KK Shtërpçë) - zona për zhvillimin e turizmit dimëroro-sportiv dhe uikendo piknik. Për ndërtim turistik janë propozuar dy lokacione:

lokaconi përreth hotelit Molika ku gjenden objektet ekzistuese turistike - hoteliere i cili duhet të destinohet vetëm për objekte kapitale turistike hotele dhe motele

lokacioni të ura në hyrje të PN ku janë ndërtuar uikend shtëpizat i cili duhet të destinohet për këtë lloj të objekteve turistike

- **Ujrat e Gropuar** (KK Prizren) - zona për zhvillimin e turizmit malor shëndetësor dhe uikendo-piknik. në këtë zonë, gjegjësisht në lokacionin ku gjendet shtëpia malore e ndërtuar gjatë viteve të 50-ta të shkeullit 20propozohet ndërtimi i në sanatoriumi (klinike turistiko-shëndetësore) me objekte dhe infrastruktur përcjellëse sportive-rekreative.

- **Gradanc** (KK Suahrekë) – zona për zhvillimin e turizmit malor dhe uikendo-piknik ku propozohet ndërtimi i një objektit kapital (hoteli) me objete ejera përcjellës edeh infrastrukturu sportive-rellektive.

- **Kroni i Mbretit** (KK Suharekë) - zona për zhvillimin e turizmit malor dhe uikendo-piknik ku propozohet ndërtimi i objekteve hoteliere dhe numri i kufizuar të objekteve të vogla turistike uikend-shtëpizave një objektit kapital (hoteli) me objete ejera përcjellës edeh infrastrukturu sportive-rellektive.

Këto zona duhet të rregullohen në përputhje me destinimin me qëllim të zhvillimit të aktiviteteve turistike dhe sportive-rekreative dhe ruajtjes maksimale të natyrës.

Për lokacionet të propozuara për ndërtimin e objekteve turistike duhet të bëhen planet rregullative urbane me qëllim të shfrytëzimit të zonës në përputhje me funksionin e mbrojtjes së natyrës. Ndërtimet duhet të janë të kufizuara dhe të përputhen me mjedisin natyror (objektet duhet të janë kryesisht nga druni). Duhet të ndalohet ndërtimi masiv i objekteve të vogla turistike (uikend shtëpizave) ndërsa përparsi duhet të kanë objektet kapitale turistike (hotelet, motelet dhe sanatoriumet) pasi që mundësojnë shfrytëzimin maksimal të hapësirës me dëme minimale në natyrë.

- **Zona e pronave private (livadheve)**

Si zonë e III propozohen edhe pronat private (livadhet) që gjenden afër fshatrave që kufiozhen me territorin e PN me qëllim që komunitetit lokal t'i mundësohet zhvillimi i veprtarive tradicionale në bujqësi dhe blegëtori. Këto prona shrytëzohen kryesisht për kullotje të bagëtive dhe kositje të barit që përdoret si ushqim rezerv për bagëti gjatë stinës dimërore. Këto zona gjenden në afërsi të këtyre fshatrave: Manastëricë, Lubinje e Epërme dhe e Poshtëme, Katundi i Epërm, Pllanjane dhe Delloc.

10. SFIDAT E PARKUT NACIONAL

Parku nacional gjatë vitit 2008 është përballuar me probleme të shumta të natyrave politike, administrative, organizative, financiare dhe kadrovike. Të gjitha problemet mund të diferencohen në dy grupe kryesore:

- mungesa e kushteve të mirëfillta për menaxhimin e qëndrueshëm të PN-së, dhe
- vështirësitë në mbrojtjen e resurseve natyrore të PN-së

10.1. Mungesa e kushteve të mirëfillta për menaxhimin e qëndrueshëm të PN

Problemet kryesore të Parkut nacional që janë të lidhura me mungesën e kushteve për menaxhimin e qëndrueshëm të Parkut nacional janë:

- Mungesa e investimeve për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore të PN-së. Parku nacional nuk e ka të rregulluar mënyrën e financimit, ndërsa në këtë vit nuk është realizuar asnjë projekt dhe investim në PN.
- Mungesa e infrastrukturës së mirëfilltë ligjore për menaxhimin e Parkut nacional. Për menaxhimin e resurseve natyrore, për momentin, ekzistojnë dy ligje:

- Ligji i vjetër për Parkun nacional Mali Sharr nr. 11/86 i cili është më përmbajtje të kufizuar dhe nuk i plotëson nevojat e zhvillimeve politike dhe ekonomike të Republikës së Kosovës së pas luftës 1999.
- Ligji për pyjet e Kosovës nr 2003/6 në bazë të cilit (neni 7) pyjet e Parkut nacional menaxhohen nga Agjensioni pyjor i Kosovës.

Këto ligje nuk e definojnë menaxhimin e Parkut nacional, përkundrazi krijojnë përzierje të kompetencave menaxhuese midis dy Ministrive (MMPH dhe MBPZHR) dhe dy institucioneve: Drejtorisë së Parkut nacional dhe APK-së. Në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktë interesash midis DPN, e cila është e orientuar në mbrojtjen dhe zhvillimin e resurseve natyrore të PN, dhe APK-së e cila tenton të bëjë eksploatimin (shfytëzimin) e pyjeve të PN pasi që pyjet me të cilët ata menaxhojnë jashtë PN i kanë shkatërruar.

- Mungesa e kompetencave menaxhuese të MMPH-së në gjithë territorin e PN-së. Parkun nacional, për momentin, e menaxhojnë tre organizata:
 - Drejtoria e Parkut nacional e cila menaxhon me 50 % të territorit të PN-së që gjendet në KK Prizren dhe KK Suharekë. Duhet theksuar se në komunën e Prizrenit Drejtorisë se PN janë uzurpuar kompetencat nga KK i Prizrenit në menaxhimin e Prevallës, ku DPN e ka rolin e shikuesit.
 - Drejtoria e Parkut nacional Shtërpce e cila funksionon në kuadër të institucioneve paralele serbe dhe menaxhon me pjesën e PN që gjendet në këtë komun.
 - Agjensioni pyjor i Kosovës i cili menaxhon me territorin e PN-së që gjendet në KK Kaçanik.

Mungesa e menaxhimit unik të gjithë territorit të Parkut nacional nga një organizat profesionale menaxhuese ka ndikuar në shfrytëzimin e pakontrolluar të pasurive natyrore të Parkut nacional. Kjo gjendje, gjithashtu, paraqet penges për hartimin e Planit hapësinor dhe Planit menaxhues të Parkut nacional, si dhe tërëheqjen e investimeve nga investitorët ndërkombëtar që veprojnë në Kosovë.

- Mungesa e definimit të strukturës organizative dhe të kuadrit të nevojshëm profesional, në veçanti të ekspertëve juridik dhe ekonomik.

- Mos realizimi i fletëparaqitjeve në Gjykatat komunale si pasoj e shkaqeve të ndryshme, siç janë:
 - Mos definimi i çeshtjeve ligjore në ligjet ekzistuese: kompetencat menaxhuese, dispozitat ndëshkuese etj,
 - Mos veprimi i duhur i Gjykatave komunale,
 - Mungesa e juristit në PN-në për përfaqësimin e lëndeve,
 - Mos egzistimi i xhirollogarisë së caktuar për Parkun nacional që do të lehtësonte përcjelljen e realizimeve të pagesave të dëmkompenzimeve për lëndët e shqyrtuara.
- Kushtet e vështira për punë të punëtorëve të Drejtorisë së Parkut nacional të cilit kryesisht angazhohen në terren. Drejtoria e Parkut nacional merret me menaxhimin e resurseve më të çmuara natyrore të Republikës së Kosovës dhe në mënyrë drejtëpërdrejt ballafaqohet me problemet në terren. Për shkak të natyrës së punës së Parkut nacional, parashtrohet nevoja që kushtet për punë të punëtorëve të dallohen në krahasim me organizatat e tjera të cilët kanë karakter monotorues. Duke marr parasysh natyrën e punës (menaxhimi i resurseve natyrore), vështirësitë (puna në terren) dhe rrezikshmërinë në punë (kërcënimet nga kriminelet) nevojitet krijimi i kushteve të mirëfillta për punë, siç janë: paga e mirëfilltë, shtesë të pagës për rrezikshmëri, kompenzim për punën ditëve të uikendit, sigurimi i shujtes (ushqimit) për terren, furnizimi i punëtorëve me uniforma zyrtare për stinën verore dhe dimërore, furnizimi me motorrola dhe mbushje telefonike, dhe armatosja e kujdestarëve.

10.2. Vështirësitë në mbrojtjen e resurseve natyrore

Në shfaqjen e problemeve në mbrojtjen e resurseve natyrore, përveç faktorëve natyror (biotik dhe abiotik), kanë ndikuar edhe problemet që kanë të bëjnë me mungesën e kushteve të mirëfillta për menaxhimin e PN-së, në veçanti mungesa e investimeve dhe kompetencave menaxhuese mbi tërë territorin e PN si dhe mungesa e kompetencave menaxhuese mbi pyjet që paraqesin resursin kryesor natyror të PN.

Problemet kryesore në mbrojtjen e resurseve natyrore të Parkut nacional kanë qenë:

- Prerjet ilegale të pyjeve të ahut në rajonet menaxhuese: Grekoc, Mushtisht dhe Delloc të njësisë ekonomiko-menaxhuese „Malet e Mushtishtit” që gjenden në territorin e KK Suharekë.
- Tharja e pyjeve të rrobullit në rajonet e Prevallës, Oshlakut dhe Pishës së Madhe, si pasoj e zjarreve pyjore në vitin 2000 dhe 2007 si dhe zhvillimit të insekteve dëmtues (nënivorësve). Në kuadër të këtyre pyjeve gjenden tre rezervate rigorozë natyrore: „Maja e Arnenit” (30 ha), „Pisha e Madhe” (35 ha) dhe Oshlaku (25 ha),
- Shfrytëzimi i gurit në rezervatin strikt të natyrës „Rusenica” dhe Oshlak,
- Gjendja e vështirë shëndetësore të pyjeve të ahut në rajonet e Lubinjës dhe Manastrecit si pasoj e dëmeve të konsiderueshme nga fatkeqësia natyrore (bora dhe era),
- Gjuetia ilegale në Oshlak, Konjushkë, Ujrat e Gropuar dhe Rusenicë, që është shfaqur koh pas kohe gjatë ditëve të uikendit.
- Ndërtimet ilegale në Prevallë, në kaduër të fshatit turistik dhe kampingut veror etj.

11. REKOMANDIMET PËR MENAXHIMIN E QËNDRUESHËM TË PN

Për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm (mbrojtjen dhe zhvillimin) të resurseve natyrore të Parkut nacional „Malet e Sharrit”, nevojitet aplikimi i masave të gjithanshme, në kuadër të cilëve veçohen:

1) Masat për krijimin e kushteve për menaxhimin e qëndrueshëm të PN

- **Kompletimi (definimi) i infrastrukturës ligjore për menaxhimin e PN, që nënkupton:**
 - Hartimin e Ligjit për parqet nacionale
 - Hartimin e amandamentit për ndryshimin e nenit 7. të Ligjit mbi pyjet 2003/6 dhe nenit 1.1. të UA nr. 07/2003, dt. 17.12.2003. nga ku duhet hequr fjalët „...dhe pyjeve në parqet nacionale në Kosovë“, ndërsa neni 1.2. të UA duhet të hiqet (anullohet) terësisht me qëllim të definimit të kompetencave menaxhuese mbi pyjet e Parkut nacional midis MMPH dhe MBPZHR.
 - Hartimin e Udhëzimit Administrativ për themelimin, përgjegjësitë, funksionet dhe organizimin e organizatës publike shtetërore ose Agjensionit për menaxhimin e PN
 - Hartimin e Rregullorës për rendin e brendshëm të PN
 - Aprovimin e dokumenteve ligjore të lartëcekura
- **Definimi i aspekteve organizative dhe kadrovike të PN, që nënkupton:**
 - Përcaktimin e organizatës (ndërmarrjes shtetërore publike) e veçantë profesionale për menaxhimin e PN „Malet e Sharrit“ në kuadër të Ligjit të ri për Parqet nacionale
 - Hartimin dhe aprovimin e Udhëzimit Administrativ për themelimin, përgjegjësitë, funksionet dhe organizimin e Agjensionit për PN „Malet e Sharrit“
 - Formulimin e strukturës organizative të organizatës për menaxhimin e PN
 - Përcaktimin e numrit dhe strukturës profesionale dhe nacionale të punëtorëve të PN
 - Sigurimin e kushteve të mirëfillta për punë: sigurimi i objektit (zyrëve) në qytetin e Prizrenit, furnizimi me pajisje për zyre dhe terren, uniforma zyrtare, armë për vetmbrojtje, rritja e pagave, sigurimi i medijeve për punën jashtë orarit, shujtjes për terren etj.
- **Formulimi i mënyrës (sistemit) të finansimit të PN, që nënkupton:**
 - Definimin i aspekteve finansiare të PN në kuadër të Ligjit për parqet nacionale (Drejtoria e PN duhet t'i kryej veprimtaritë ekonomiko-finansiare që janë të nevojshme për menaxhimin e PN)
 - Formimin e buxhetit të PN me xhirollogari të veçantë që funksionon në kuadër të Buxhetit të MMPH (Qeverisë)
 - Aplikimin e pagesave (taksave) nga Drejtoria e PN për shfrytëzimin e resurseve natyrore dhe ushtrimin e veprimtarive komerciale në territorin e PN
 - Përcaktimin e buxhetit vjetor të Parkut nacional në kuadër të MMPH dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës
- **Hartimi i bazës planifikuese të Parkut nacional (Planit Hapësinor dhe Planit Menaxhues)**
 - Hartimi dhe aprovimi i Planit Hapësinor të PN
 - Formimi i ekipit profesional për hartimin e Planit Menaxhues të PN
 - Angazhimi i eksperteve ndërkombëtar për asistencë dhe këshillime profesionale të stafit vendor
 - Hartimi dhe aprovimi i Planit menaxhues të PN
 - Hartimi i Planeve rregullative urbane për zonat e planifikuara për ndërtim turistik

2) Masat për mbrojtjen e resurseve natyrore në rezervatet strikte natyrore ekzistuese

- Ndalimi i shfrytëzimit të gurit në rajonin e Rusenicës, dhe sanimi gjendjes së natyrës së degraduar,
- Mbyllja (gropimi me eskavator) e rrugëve pyjore për lëvizje të mjeteve transportuese, në vendet Rapufa (Rajoni i Grekocit) dhe Gryka e Rusenicës (Rajoni i Mushtishtit),
- Sigurimi i ushqimit për rreqëbullin në sezonën e dimërit dhe gjatë periudhës së zhvillimit të klushëve të tij,
- Vendosja e feromoneve (kurtheve) për asgjесimin e insekteve dëmtues (nënlivorësve) në rezervatet e pyjeve të rrobullit.
- Angazhimi i ekspertëve ndërkombëtarë që kanë pasur përvoj me tharjen e pyjeve në parqet nacionale evropiane dhe botërore.

3) Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve

- Kuqja më serioze e institucioneve shtetërore (qëndrore dhe lokale) në parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve.
- Realizimi i Projekteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e pyjeve të dorëzuara në MMPH.
- Drejtoria e PN duhet të ketë kompetencat e plota menaxhuese mbi të gjitha resurset natyrore të Parkut nacional, duke nënkuptuar edhe pyjet, dhe nuk duhet lejuar përzjerjen e APK-së në menaxhimin e pyjeve të PN
- Inventarizimi i pyjeve dhe hartimi i planeve menaxhuese afatgjate për menaxhimin e pyjeve të Parkut nacional,
- Shpallja e pyjeve më të rëndësishme të PN si zonë strikte natyrore siç janë pyjet e rrobullit, arnenit, dredahkut etj.
- Vendosja e punktut kontrollues (24 orëshe) në vendin Kulla (Mushtisht) për ndalimin e lëvizjeve (hyrjes) të automjeteve dhe traktorëve në territorin e PN.
- Mbyllja (gropimi me eskavator) e rrugëve pyjore për lëvizje të traktorëve në vendet: Guri i Kuq, Kroni i Mbretit, Rrafshi i Uflave dhe Rusenicë.
- Punësimi i ekspertit juridik në DPN ose caktimi i një juristi nga Zyra Ligjore e MMPH.
- Ndikimi institucional në Gjykatat Komunale të Prizrenit dhe Suharekës për shqyrtimin e lëndëve të PN-së me procedur urgjente.
- Furnizimi i DPN-së me pajisje kundër zjarreve (aparate, netulla metalike, bucela për ujë, sharra etj.)
- Furnizimi me feromone për asgjесimin e insekteve dëmtues (nënlivorësve) dhe vendosja e tyre në pyjet halore në Prevallë, Pisha e Madhe, Ujrat e Gropuar dhe Pashallare.
- Aplikimi i pastrimeve dhe rrallimeve sanitare të pyjeve që i takojnë zonës se II të mbrojtjes.
- Monotorimi i vazhdueshëm i pyjeve në pronësi private dhe dhënja e këshillave profesionale për mbrojtjen e pyjeve nga faktorët biotik (insektet dhe sëmundjet bimore) për pronarët e pyjeve.
- Verifikimi i kufijve të pronave private në brendësi të territorit të PN, për t'i evituar uzurpimet eventuale të pronës shtetërore.
- Sensibilizimi i opinionit të gjerë nëpërmjet reklamave edukativo-informative në mjetet e informimit (TV, radio dhe gazeta) për mbrojtjen dhe ruajtjen e pyjeve dhe mjedisit.

4) Masat për mbrojtjen e florës dhe menaxhimin e qëndrueshëm të kullosave

- Sigurimi i pajisjeve për hulumtimin e resurseve natyrore në terren (foto aparat profesional, kompjuter lap-top, video kamer, projektor, herbar, Wertrex për matjet pyjore, tryelja e preslerit, etj.).
- Monotorimi i vazhdueshëm i gjendjes së florës, në veçanti të llojeve të rrezikuara endemike dhe mjekuese.
- Inventarizimi i florës dhe krijimi i databazës për florën e PN.
- Ndalimi i mbledhjes së bimëve mjekuese, në veçanti të sanëzës dhe llojeve të tjera të rrezikuara.
- Ndalimi i shfrytëzimit të kullosave në vendet ku gjenden bimët endemike.
- Ndalimi i shfrytëzimit të kullosave për blegëtorët që nuk i kryjnë obligimet ndaj DPN.
- Shpallja e zonave të pasura me bimë endemike si rezervate strikte të natyrës.
- Mbikëqyrja e shfrytëzimit të sipërfaqeve barishtore dhe kullosave në pronësi private.
- Vendosja e tabelave informative dhe ndaluese në vendet e caktuara të PN.

5) Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e faunës

- Mmonotorimi i vazhdueshëm i gjendjes së kafshëve të egra
- Inventarizimi i kafsheve të egra dhe hartimi i planeve menaxhuese për menaxhimin e tyre,
- Ndërtimi i vëzhgimorëve për përcjelljen e gjendjes së kafshëve të egra, në zonat e ndryshme të Parkut nacional.
- Rregullimi i vendushqimeve dhe vendkryporeve për vendosjen e ushqimit për kafshët e egra,
- Sigurimi i ushqimit për kafshët e rrezikuara (reqëbulli, kaprolli, dhija e egër dhe disa shpendë) gjatë stinës dimërore kur për shkak të shtresës së trash të borës në pjesët malore të Parkut nacional paraqitet mungesa e ushqimit për këto kafshë.
- Parandalimi i gjuetisë ilegale me anë të kontrollave dhe intervenimeve në terren dhe sanksionimi i personave që i shkelin rregullat ligjore.
- Organizimi i kujdestarisë në terren gjatë sezonës së gjuetisë për të parandaluar hyrjen e gjahtarëve në territorin e PN
- Bashkëpunimi i mirëfilltë me shoqatat e gjahtarëve që veprojnë në rajonet që kufizohen me territorin e PN.

6) Masat për zgjidhjen e çështjes së ndërtimeve dhe menaxhimin e qëndrueshëm të vendeve turistike

Për zgjidhjen e çështjes së fshatit turistik në Prevallë propozohen këto masa:

- Marrja e Vendimit për shfuqizimin (anulimin) e Planit Rregullativ Urban Prevalla pasi që është në kundërshtim me ligjet, konventat dhe funksionin e mbrojtjes së vlerave natyrore të PN.
- Ndalimi i të gjitha llojeve të ndërtimeve në territorin e Parkut nacional deri në hartimin dhe aprovimin e Planit Hapësinor për PN dhe Planeve Rregullative Urbane për zonat e dedikuara për ndërtim turistik, që duhet të zbatohet nga të gjitha institucionet kompetente në nivelin lokal dhe qëndror, ku rolin kyqë e kanë inspekcionet, policia, prokuroria dhe gjykatat.

- Hartimi i Planit të ri Rregullativ Urban për Prevallën në përputhje me zonimin dhe Planin Hapësinor. Ndërtimet duhet të planifikohen vetëm në kuadër të zonës së tretë të dedikuar për ndërtim, ndërsa të gjitha ndërtimet jashtë zonës së përcaktuar për ndërtim duhet të rrenohen dhe gjendja e natyrës të sanohet duke e kthyer në gjendjen e mëparshme. Të gjitha interesat duhet të përputhën (harmonizohen) me interesin e PN e jo që interesi shtetëror të harmonizohet me interesat parçiale. Mendojmë se kjo mund të realizohet pasi që në kuadër të zonës së planifikuar për ndërtim nga zonimi i PN janë dhënë 4, 6, 8 apo 10 leje të ndërtimit për një person të cilët mund të shpërndahen personave të tjerë që kanë aplikuar.

Për zgjidhjen e çështjes së kampingut veror në Prevallë propozohen këto masa:

- Kampingu ekzistues në lokacionin ku gjendet duhet të anulohet (shuhet) dhe të zhvendoset në zonën e planifikuar për kamping sipas zonimit të Prevallës (Raporti për zonimin e rajonit të Prevallës nr. 07/1742/1 të datës 09.08.2007.) dhe në bazë Planit (Projektit) të caktuar, ndërsa natyra e dëmtuar duhet të sanohet dhe të kthehet në gjendjen e më parshme.
- Hartimi i Planit (Projektit) kualitativ për rregullimin e „kampingut veror” në bazë të tenderit të shpallur i cili duhet të miratohet dhe aprovohet nga Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës në përputhje me zonimin (Planin Hapësinor) dhe aktet ligjore.
- Kampingu duhet të funksionoj në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës (MMPH) dhe nën mbikqyrjen e plotë të Drejtorisë së PN.

Për zgjidhjen e çështjes së ndërtimeve në Brezovicë propozohen këto masa:

- Zona e ndërtimeve aktuale në Brezovicë në hyrje të PN të përcaktohet si zonë e III për ndërtim në kuadër të zonimit i cili është duke u kryer, ndërsa në të ardhmën objektet e ndërtuara duhet të përshtaten kritereve të ndërtimit në PN.
- Ndalimi i të gjitha llojeve të ndërtimeve deri në hartimin dhe aprovimin e Planit Hapësinor për PN dhe Planit Rregullativ Urban për zonat e dedikuara për ndërtim turistik.
- Hartimi i Planit Rregullativ Urban Brezovica në përputhje me zonimin (Planin Hapësinor) i cili duhet të merr parasysh gjendjen (ndërtimet) ekzistuese.
- Nëse ekzistojnë ndërtimet në pronën shtetërore, ato duhet të nënshtrohen procedurës së rrenimit dhe sanimit të natyrës duke e kthyer në gjendjen e mëparshme.

Rekomandimet (propozimet) e lartëcekura për zgjidhjen e çështjes së ndërtimeve në Prevallë dhe vendet e tjera të Parkut nacional, janë të bazuara në ligjet e Republikës së Kosovës, direktivat dhe konventat ndërkombëtare (UN, EU etj.), zonimin (Planin Hapësinor) e PN dhe menaxhimin e qëndrueshëm (mbrojtjen dhe zhvillimin) e resurseve natyrore të Parkut nacional.

Masat e tjera për rregullimin e vendeve turistike

- Ndalimi i hyrjes së automjeteve në brendësi të PN-së me anë të vendosjes së rampave dhe pengesave nga dheu ose piramidat e betonit në rrugët pyjore në Prevallë, Gurin i Zi, Ujrat e Gropuar, Gradancë dhe Kroni i Mbretit.
- Vendosja e tabelave informative dhe ndaluese në Prevallë, Gurin e Zi, Ujrat e Gropuar dhe Gradancë
- Rrenimi i objekteve ilegale në Gradanc dhe Kroni i Mbretit dhe rikthimi i gjendjes së mëparshme të natyrës.
- Hartimi i Planeve Rregulaltive urbane në bazë të Planit Hapësinor për vendet turistike: Guri i Zi, Ujrat e Gropuar, Gradancë dhe Kroni i Mbretit.

- Aplikimi i masave ligjore kundër personave që i shkelin dispozitat ligjore.
- Aplikimi i taksave për shfrytëzimin e territorit të PN për turizëm dhe rekreacion.
- Për mbikqyrjen më efektive të veprimtarive komerciale në territorin e PN në vendet e caktuar si psh. në Prevallë dhe Gradancë duhet të punësohen punëtorët sezonal.

7) Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore

- Shfrytëzimi i resurseve natyrore (zhvillimi i veprimtarive të lejuara komerciale) të PN duhet të jetë nën mbikqyrjen e plotë të DPN.
- Shfrytëzuesit e resurseve të PN duhet të posedojnë lejen (kontratën) për ushtrimin e veprimtarisë nga DPN dhe të paguanë në xh.ll. e MMPH-së (Qeverisë) taksat e caktuara sipas kontratës dhe çmimit për shfrytëzimin e resurseve të PN.
- Shfrytëzimi ilegal i pasurive të PN duhet të ndalohet në bashkëpunim me inspektionin komunal dhe të MMPH dhe rastet të paraqiten në gjykatat përkatëse.

Këtij raporti është bashkangjitur raporti tabelar i dëmeve pyjore nga prerjet ilegale për vitin 2008.

Data: 29.12.2008.

Prizren

Raportin e përpiluan:

Hazer Dana, drejtor i DPN

Mr. Sc. Nail Kryeziu, zyrtar për pylltari

Xhavit Mala, zyrtar i lartë për natyrë

Sunaj Kabash, zyrtar për hidr. dhe klim.

Sami Memaj, teknik i pylltarisë

Xhezair Smaili, nëpunës për faunë

Iliaz Nesho, teknik i gjeodezisë